



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 225/7 prot.

Tiranë, më 15 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 204 , datë 15 . 08 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, mori në shqyrtim ankesën nr. 22 Regj., datë 31.01.2025, paraqitur nga subjekti ankues, Qendra “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”, kundër shtetases D. M², në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “identitetit gjinor” dhe “orientimit seksual”.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, subjekti ankues parashtron, ndër të tjera, se:

“...në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës Maj 2024 - Janar 2025, shtetasja D. M, ka qenë ftuar në disa emisione televizive, dalje publike si dhe mjaft prezente në mjedisin online, nëpërmjet profileve të saj zyrtare në rrjetet sociale..... dhe gjatë këtyre formave të paraqitjeve publike, qofshin emisione televizive, podcaste apo shkrime në postime në rrjete sociale, si forma të drejtëpërdrejta komunikimi me publikun e gjerë, është folur dhe janë trajtuar tema të ndryshme, kryesisht të lidhura në një mënyrë apo në tjetrën me konceptin e familjes, jetës familjare, të drejtat në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues, vlerat riprodhuese, vlerat demokratike e shoqërore dhe çështjet

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Të dhënat e subjektit u morën nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB-së), Ekstrakti i Regjistrat Tregtar për të dhënat e subjektit “Person Fizik”, me NUIS – L81714001F.

e LGBTI+, ku D. M, në mënyrë të përsëritur, ka marrë përsipër të bëjë deklaratat të ndryshme publike ndaj personave, aktivistëve, komuniteteve dhe organizatave LGBTI+ në Shqipëri.

...paraqitja publike e znj. M gjatë periudhës Maj 2024 e deri më sot, mbart elemente të diskriminimit të drejtëpërdrejtë, të gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes për të diskriminuar për shkak të karakteristikave të mbrojtura të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Pretendojmë se kontenti dhe momentum (muaji Maj 2024, i quajtur ndryshe dhe “Muaji i krenarisë LGBTI+”) në të cilin kanë nisur të kryhen paraqitjet dhe deklaratat publike, bën që ato të meritojnë një vëmendje të shtuar, pasi efekti dhe impakti i tyre në shoqëri gjatë kësaj periudhe ka qenë i amplifikuar, për shkak të karakterit të muajit Maj, ngjarjeve të ndodhura në periudhën kohore Maj 2024 - Janar 2025, në lidhje me komunitetën LGBTI+, në botë, dhe momentumit të krijuar në Shqipëri (përfshirë ceremoninë simbolike të celebrimit të dy grave lesbike në Tiranë).

Pala ankuese ka pretenduar për përdorim të gjuhës së urrejtjes nga ana e znj. M, në daljet e saj respektivisht si më poshtë citohet, në:

- Televizionin Abc News, në emisionin “Bardh a Zi³”, të datës 22 Maj 2024⁴;
- Podcard-ShpresON⁵, platforma You Tube, të datës 16 Maj 2024⁶;
- Podcard-ShpresON⁷, platforma You Tube, të datës 18 Maj 2024⁸;
- Shqipëria Live⁹, në platformën You Tube, të datës 24 Dhjetor 2024¹⁰;
- E diell¹¹, në platformën You Tube, të datës 12 Janar 2025¹²;
- Shije shtëpie, në platformën You Tube¹³;
- Alarm, në platformën You Tube¹⁴;
- Kosova Today, në platformën You Tube¹⁵;
- True Podcast nga Sh. G¹⁶, në platformën You Tube, të datës 5 Janar 2025¹⁷;

³ Shkëputur citimet e saj respektivisht në minutat 1:40, 5:10, 6:35, 24:20, 25:11, 25:32, 27:36, 27:58, 28:27, 31:18 dhe 38:26, të emisionit.

⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=WTepZ8KyZp0&t=2518s>

⁵ Shkëputur citimet e saj respektivisht në minutën 50:08, të emisionit.

⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=arma8Eec&t=610s>

⁷ Shkëputur citimet e saj respektivisht pas minutit 12 dhe në minutat 30:30, të emisionit.

⁸ <https://www.youtube.com/watch?v=ds7XKGcPG6s>

⁹ Shkëputur citimet e saj respektivisht në minutat 1:22-2:55, 3:10-4:40, të emisionit.

¹⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=4gD8T8t30o8>

¹¹ Shkëputur citimet e saj respektivisht në minutat 1:48, 3:00, 7:22- 9:30, të emisionit.

¹² <https://www.youtube.com/watch?v=1azbJvEN9EA>

¹³ <https://www.youtube.com/shorts/9z6Qs3fuxLE>

¹⁴ https://www.youtube.com/shorts/_BhBIRuoa5M

¹⁵ <https://www.youtube.com/shorts/ZUVZ1hDYos>

¹⁶ Shkëputur citimet e saj respektivisht në minutat 3:45, 4:40 - 5:50, 8:26, 9:30. 10:16, 10:50, 12:18, 30:09, 43:50, të emisionit.

¹⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=Lq3dMB&ULRA&t=1s>

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri: *“Marrjen e një vendimi të drejtë që tregon kujdes të veçantë në konsiderimin e raportit të hollë mes lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe konstatimin e elementëve diskriminues në lidhje me momentet e parashtruara, në funksion të shmangies dhe parandalimit të praktikave të rrezikshme për demokracinë dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri”.*

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimiti, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:*

.....
b) legjitimitin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative.”

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t'i referohemi LMD-së, rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se: *“1. Komisioneri ka kompetencë:*

- a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;
- b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj.”

Referuar parashikimit të shkronjës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive.

“Interesi i ligjshëm” është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimitimin e saj në kryerjen e ankesës.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me nr. 567/2, datë 25.10.2024, nëpërmjet së cilit Qendra “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”, është regjistruar si person juridik, si dhe Vërtetimit datë 11.11.2024, të po kësaj Gjykate, konstatohet se: “Qëllimi i Qendrës është që Aleanca, përfytyron një shoqëri shqiptare të lirë, të hapur dhe të barabartë që përqafon të ndryshmen dhe është gjithëpërfshirëse ndaj personave me orientime dhe identitete gjinore të ndryshme. Për të realizuar këtë vizion Aleanca përpigjet të mbështesë, fuqizojë dhe të rrisë dukshmërinë e komuniteteve të homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinorëve, duke rritur ndërgjegjësimin dhe nivelin e informimit të publikut mbi çështjet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, pa cenuar dispozitat ligjore, të realizojë fushata për ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut mbi çështjet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor.”

Mbështetur në përmbajtjen e aktit të regjistrimit dhe Statutit të Shoqatës, rezulton se forma e organizatës jofitimprurëse, është ajo e Shoqatës, parashikuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe objekti dhe qëllimi kryesor i veprimtarisë së Shoqatës, ndër të tjera është të mbështesë, fuqizojë dhe të rrisë dukshmërinë e komuniteteve të homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinorëve, të rrisë ndërgjegjësimin dhe nivelin e informimit të publikut mbi çështjet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, pa cenuar dispozitat ligjore; të realizojë fushata për ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut mbi çështjet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, etj.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 567/2, datë 25.10.2024, rezulton se, Xh. K është zgjedhur Drejtore Ekzekutive e Qendrës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”¹⁸,

¹⁸ Me një mandat 1 (një) vjeçar, duke filluar nga data e miratimit të këtij Vendimi.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

e cili bazuar në kompetencat e parashikuara në aktet përkatëse rregullatore, ka tagrin e përfaqësimit të Qendrës, në marrëdhënie me institucione të ndryshme dhe me persona të tretë.

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët janë e ndjehen pjesë e grupeve të mbrojtuar nga kjo Shoqatë. Mbështetur në objektin e veprimtarisë së Qendrës, sipërcituar në vendim, Komisioneri gjykon se Qendra, përfaqësuar nga Xh. K (Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës) po ashtu dhe nga Av. D. N¹⁹, legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të mbrojtjes së të drejtave të personave LGBT, si kategori personash e mbrojtur prej tyre.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe, në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të tij, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 225/1 prot., datë 11.02.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga znj. D. M, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
2. Në vijim, nëpërmjet shkresës datë 24.02.2025²⁰ znj. D. M, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e saj lidhur me pretendimet e subjektit ankues, (shkresë e administruar në dosjen përkatëse pranë KMD-së), duke shprehur ndër të tjera, se:

“Deklaratat e mia nuk përbëjnë gjuhë urrejtje apo diskriminim sipas legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar.

Duke qenë se çdo individ ka të drejtën e tij të shprehë mendimin mbi politikat publike dhe të diskutojë çështje me ndikim në shoqëri, unë e kam ushtruar këtë të drejtë brenda kornizës demokratike.....

Në daljet e mia publike për tema sociale në Opinion, si dhe në emisione të tjera, njerëzit kanë pëlqyer analitikat e mia, duke qenë sërish e ftuar. Arsyeja pse më ftonin, siç pohojnë edhe vetë gazetarët, ishte formulimi i një komunikimi me teleshikuesit për paqe dhe balancë midis komuniteteve, respekt dhe dhënien e prioritetit përtej egoizmit tonë, gjeneratës së re dhe fëmijëve. Është thënë nga teleshikuesit se D flet gjithmonë të vërtetën, një faktor që e vëreni në shumë komente. Jam përpjekur të promovoj sportin, një jetë të shëndetshme, lirinë, një grua moderne, të promovoj një brez të shëndetshëm mendërisht dhe të fortë për t’u përballur me çdo sfidë. Unë motivoj për të ngrotur brezin e ri dhe jo për t’u zhytur në dështim, dëshpërim dhe depresion.

Një nga arsyet që ne duhet të ngremë zërin ndaj fëmijëve trans është publikimi që gjeni online nga shumë mjekë, shkencëtarë dhe studiues të efekteve negative që kanë këto “hormon blockers”, të

¹⁹ Me nr. licence 12892 dhe ID J75225061A

²⁰ Protokolluar me Tonën/KMD me nr. 225/2 prot., datë 26.02.2025.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

cilët mund të shkaktojnë dobësimin e shëndetit kockor, çrregullimin e shëndetit mendor, deri tek kanceri, etj. Në këtë mënyrë ne thjesht po mundohemi të mbrojmë shëndetin e së ardhmes. Këto të dhëna dhe studime mund të gjenden lehtësisht online²¹.

Unë si nënë jam shumë e shqetësuar se si ne po neglizhojmë një studim të tillë. Është diskutuar në një nga takimet e koalicionit të familjes me prindërit dhe personalitete, sa i rëndësishëm është shëndeti i fëmijëve para gjithçkaje. Fjalët e D. M përmbledhen në shëndetin e fëmijës dhe në një botë më të mirë, më të paqtë dhe pa përplasje.

Unë jam e hapur për çdo debat konstruktiv dhe tryezë miqësore me çdo komunitet për të diskutuar në gjetjen e një balance paqësore, socialo-shoqërore dhe për ruajtjen e shëndetit të fëmijëve dhe trashëgimive kombëtare. Nuk besoj se bëjnë shqetësim karakteri im besnik ndaj kombit tim, traditës që më ka rritur, prindërve të varfër që më kanë rritur, nënës dhe babës, dhe dashurisë që kam për të vegjlit në këtë botë të ftohtë, ku dëshirat tonë prej të rriturish po vijnë përpara të fëmijëve.

Orinetimi im konservator vjen nga dëshira ime e madhe për të promovuar familjen, trashëgiminë gjenetike të trojeve shqiptare, për të krijuar një shtet sovran me dinjitet dhe për të sjellë një Shqipëri më të fortë dhe më të mirë për fëmijët tanë. Dobësimi i institucionit të familjes, ulja e lindshmërisë së fëmijëve, janë dy faktorë që shkaktojnë dëmtimin e një kombi. Unë advokoj për një Shqipëri të ndritur, të trashëguar ndër breza, me popull të shëndetshëm, me familje të shëndetshme.

Qëllimi im i mirë duhet të merret parasysh në gjykimin e kësaj çështjeje, pasi nuk kam asnjë qëllim tjetër si personazh publik.

Kam thënë edhe publikisht se nuk kemi të drejtë të hyjmë në jetën private të të rriturve. Në çdo dalje publike dhe paraqitje televizive, kam mbrojtur dhe advokuar në mënyrë të vazhdueshme mbështetjen për luftën kundër bullizmit ndaj komunitetit LGBTQ+, si dhe hartimin e politikave ekonomike dhe sociale që promovojnë dhe garantojnë të drejtat e tyre, duke thënë edhe tek Shqipëria Live, se ata janë talente në shumë sfera të punësimit. Në asnjë moment nuk kam kërkuar apo sugjeruar cenimin e tyre në çfarëdo forme. Përkundrazi, në çdo argumentim timim kam theksuar dhe cituar të drejtat e tyre themelore, duke theksuar se ata janë të paceueshme dhe nuk mund të kufizohen apo mohohen nga asnjë individ apo entitet.”

Znj. M shprehet se në asnjë rast nuk ka refuzuar të drejtat e komunitetit LGBT, dhe se kritikën e saj drejtohen ndaj politikave dhe jo individëve, dhe se, kritikimi i këtij komuniteti nuk përbën automatikisht diskriminim.

Znj. M ka prapësuar provat e paraqitura, duke u shprehur se paa ankueset i ka nxjerrë dhe interpretuar jashtë kontekstit fjalët e saj. Ajo citon se: “Faktet e paraqitura nga pala ankuese bien në kundërshtim me transkriptet e plota të bashkëngjitur, të cilat dëshmojnë qartë se diskutimet dhe debatet e zhvilluara në kuadër të paneleve mbi politikën publike dhe çështjet ligjore kanë qenë të përqendruara ekskluzivisht në analizimin dhe interpretimin e ligjeve, politikave dhe agjendave

²¹ Znj. M ka bashkëlidhur linkun: <https://acpeds.org/transgender-interventions-harm-children>

publike. Këto diskutime nuk kanë përfshirë në asnjë rast individët e komunitetit LGBT, por kanë trajtuar çështje të politikave shtetërore dhe kornizave ligjore që rregullojnë të drejtat e detyrimet e të gjithë qytetarëve, pa diskriminim dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se asnjë anëtar i komunitetit LGBT nuk është dëmtuar, diskriminuar apo trajtuar në mënyrë të padrejtë si rezultat i këtyre diskutimeve. Përkundrazi, debati ka qenë gjithmonë i përqendruar në aspekte ligjore dhe institucionale, duke respektuar parimet e barazisë dhe të drejtave themelore të njeriut. Për më tepër, unë kam individë nga vetë komuniteti LGBT që më mbështesin dhe konfirmojnë faktin se diskutimet e mia kanë qenë të udhëhequra nga parimet e lirisë së shprehjeje edhe debatit konstruktiv, pa synuar kurrë të cenoj askënd në mënyrë personale apo të nxis ndonjë formë diskriminimi.”

Znj. M, ka sqaruar, lidhur me pjesëmarrjen e saj në panele diskutimi dhe interpretimin e deklaratave të saj nga pala ankuese, se: “Deklaratat e mia, të cilat janë objekt i kësaj ankese, janë bërë pjesë e paneleve të diskutimit televiziv mbi tema të rëndësishme shoqërore dhe ligjore. Është e rëndësishme të theksohet se çdo diskutim i tillë përfshin shkëmbime të mendimeve dhe analizë të thelluar mbi çështje të debatueshme.

Në dokumentin e mëposhtëm, paraqitet transkripti i plotë i minutave përkatëse të diskutimit²², për të treguar kontekstin e plotë të deklaratave të mia. Në këtë mënyrë, është e qartë se:

- Deklaratat e mia janë nxjerrë jashtë kontekstit dhe janë interpretuar në mënyrë të shtrembëruar;
- Qëllimi im ka qenë të analizoj ligjet dhe jo të sulmoj individët e komunitetit LGBT;
- Fokusimi në fjalë të veçuara, pa analizuar të gjithë diskutimin çon në keqkuptime dhe interpretime të gabuara.”

3. Ne vijim te procedurat e shqyrtimit të ankesës kundër znj. D. M, si dhe ne zbatim të parimit të barazisë së armëve për një proces të drejtë e të paanshem, nëpërmjet e-mailit datë 25.03.2025, subjektit ankues i janë dërguar për njohje parashtrimet e depozituara nga znj. M.
4. Nëpërmjet e-mailit datë 02.04.2025, drejtuar Komisionerit, subjekti ankues bën me dije KMD-në, se i qëndron të njëjtave argumente si në ankesën fillestare dhe se mban të njëjtin qëndrim, duke mos depozituar argumente shtesë.
5. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 225/3 prot., datë 25.04.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

²² Shkresë e cila është administruar në cilësi prove nga KMD.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

6. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 30.04.2025, pranë Zyrës së Komisionerit, në prani të palëve në proces. Pala ankuese u përfaqësua në këtë seancë nga Av. D. N dhe XH. K, drejtore ekzekutive e Qendrës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”.
Pala kundër së cilës është depozituar ankesa ishte e pranishme personalisht në seancë, si dhe e asistuar nga Av. A. G.

Secila nga palët ju përmbajt argumentave të depozituara shkresërisht pranë KMD-së, (pasqyruar këto në procesverbalin e mbajtur gjatë seancës, si dhe regjistrimin audio të saj²³). por përfaqësuesi ligjor i znj. M evidentoi dhe shtjelloi edhe këto elementë:

- Faktet e paraqitura dhe të pretenduara nga pala ankuese nuk përbëjnë prova, pasi nuk janë marrë në formën e kërkuar nga ligji;
- Frazat dhe fjalitë e shkëputura nga pala ankuese përbëjnë copëza të vecanta dhe ku mungon transkripti i plotë i bisedës apo i paragrafëve të deklarimeve të znj. M dhe si të tilla nuk mund të merren si prova;
- Znj. M është përndjekur nga pala ankuese, pasi është monitoruar për 8 (tetë) muaj radhazi nga ana tyre, si dhe i janë bërë kallëzime të rreme në Polici;
- Gjatë gjithë seancës dëgjimore, znj. M dhe avokati i saj, theksojnë se deklarimet dhe qëndrimet e saj publike nuk kanë të bëjnë fare me Qendrën “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT” që përfaqësohet nga Xh. K apo komunitetin LGBT, por me individë dhe agjenda që rrezikojnë shëndetin fizik e mendor të fëmijëve, e për rrjedhojë dhe të familjes.

Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 225/6 prot., datë 05.05.2025, të Komisionerit, znj. M iu vu në dispozicion CD-ja me regjistrimin audio të seancës dëgjimore, duke i bërë me dije se, nëse do të kishte parashtrime dhe dokumentacion shtesë në vijim të saj, t’i depozitonte pranë KMD-së.

Lidhur me sa më sipër, nuk u sollën objeksione apo dokumentacion tjetër nga znj. M.

III. Legjislacioni i zbatueshëm.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë bazat e shtetit të së drejtës. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cenojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët. (Neni 3, i Kushtetutës së Shqipërisë).

Liria e fjalës dhe e shprehjes konsiston në një të drejtë themelore të njeriut. Kjo e drejtë luan rol thelbësor edhe në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera të njeriut. Koncepti i qytetarisë dhe i pluralizmit janë të përealizueshëm, nëse individëve nuk u jepet mundësia e shprehjes së lirë të mendimit. Toleranca ndaj mendimit të tjetrit dhe të ndryshmit, mundëson bashkëekzistencën në shoqëritë bashkëkohore multikulturore.

²³ Prova të cilat janë vënë në dispozicion të znj. D. M me shkresën me nr. 225/6 prot., datë 05.05.2025, të KMD-së (bazuar në kërkesën e saj datë 30.04.2025).

Pavarësisht sa më sipër, liria e shprehjes mund të keqpërdoret në situata të caktuara, duke sjellë si pasojë shkeljen e të drejtave të personave të tjerë. Në emër të “lirisë së shprehjes”, individë dhe grupe të caktuara mund të shprehin ide për superioritet të një race, feje apo etnie të caktuar, me qëllim përçmimin e të gjithë atyre, që nuk i takojnë grupit “të tyre”, si dhe të bëjnë thirrje për ndjekje, izolim, po madje edhe deri për genocid ndaj tyre. Në raste të tilla, liria e shprehjes përbën shqetësim për kategori të caktuara individësh dhe shpesh kalon deri në gjuhë urrejtjeje ndaj tyre. Pikërisht, femoneme të tilla aktualizojnë diskutimin për lirinë e shprehjes, kufizimet e saj dhe keqpërdorimin e kësaj lirie.

Në mediat shqiptare, jo në pak raste, është konstatuar se kultura e fjalës së përdorur nuk është e duhura. Njëkohësisht, është vënë re jo në pak raste jemi ndeshur me fenomenin e nxitjes, përdorimit dhe përhapjes së “gjuhës së urrejtjes” në publik për kategori apo grupe shoqërore, pa reflektuar asnjë ndjenjë përgjegjësie për fjalën e thënë në median e shkruar dhe atë televizive.

Liria e shprehjes buron nga parashikimet përkatëse në aktet juridike ndërkombëtare dhe standardet minimale të saj rezultojnë të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Shtetet palë e kanë për detyrë t’i inkorporojnë të drejtat dhe liritë në legjislacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike për të rivendosur të drejtat e shkeluara.

Barazia dhe mosdiskriminimi, janë gur themeli i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 18, të saj, Kushtetuta sanksionon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”*

Barazia dhe mosdiskriminimi janë gur themeli edhe e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë, duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se liria e shprehjes, toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore është thelbësore për një shoqëri demokratike dhe pluraliste. Lufta kundër intolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, qëndrojnë në themel të shtetit tonë. Kushtetuta, sanksionon detyrimin e shtetit, jo vetëm të mos i cënojë ato, por të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të siguruar mos cënimin, për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë²⁴ ku parashikohet shprehimisht: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*. Megjithatë, Komisioneri thekson sërish faktin se liria e shprehjes dhe mendimit nuk është një e

²⁴ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

drejtë e pakufizuar dhe se ajo nuk duhet të ushtrohet në një mënyrë të papajtueshme me të drejtat e të tjerëve.

Në bazë të nenit 17, Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Parashikimi i saj sqaron se: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”* Në këtë kontekst, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo Konventë përmban parashikime të rëndësishme mbi lirinë e shprehjes, ku përveç mbrojtjes që i siguron kësaj të drejte, përcakton edhe kufizimet përkatëse.

Për sa më sipër, në Nenin 10, të KEDNJ-së parashikohet shprehimisht: *“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.*

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Në paragrafin e parë të këtij neni përkufizohen të drejtat e mbrojtura, ndërkohë që në paragrafin e dytë të tij, përcaktohen rrethanat në të cilat një shtet në mënyrë të legjitimuar mund të ndërhyjë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes. Për më tepër, neni 10 i KEDNJ-së, mbron jo vetëm përmbajtjen e informacionit dhe ideve, por edhe formën në të cilën janë shprehur ato. Kështu, dokumentet e shkruara, transmetimet në radio dhe televizione, pikturat, filmat, apo edhe sistemet e informacionit elektronik janë gjithashtu të mbrojtura sipas këtij neni. Për pasojë, mjetet e prodhimit dhe komunikimit, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit dhe ideve mbulohen gjithashtu nga neni 10, i KEDNJ dhe institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe gjykatat duhet të jenë të ndërgjegjshëm për zhvillimet e shpejta teknologjike dhe mënyrës se si liria e shprehjes mund të ndahet nëpërmjet mënyrave të tilla.

Mbështetur në paragrafin 2, të nenit 10 të KEDNJ-së, autoritetet vendase në çdonjërin nga Shtetet Kontraktues mund të ndërhyjnë me ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen 3 (tre) kushte së bashku²⁵:

- i. ndërhyrja (në kuptimin e “formalitetit”, “kushtit” ose “sanksionit”) parashikohet me ligj;

²⁵ Carss-Frisk, M., Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane – Liria e Shprehjes;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

- ii. ndërhyrja ka si qëllim të mbrojtë një ose më shumë nga interesat ose vlerat e mëposhtme: sigurimin kombëtar; integritetin territorial; sigurinë publike; ndalimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit; mbrojtjen e shëndetit; moralit; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve; ndalimin e zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë, dhe garantimin e autoritetit të paanshmërisë së gjyqësorit;
- iii. ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nevoja për të mbrojtur “të drejtat e të tjerëve” është një moment i rëndësishëm kufizues për të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Engels and Others*, GJEDNJ është shprehur se: “nuk ka arsye që të mohosh lirinë e shprehjes, por vetëm të dënosh ushtrimin abuziv të asaj lirie.....”²⁶

Më tej, Gjykata ka garantuar lirinë e medias duke u shprehur në mënyrë të përsëritur se: “...kërkesa e përgjithshme që gazetarët të distancohen sistematikisht dhe formalisht nga përmbajtja e një citimi që mund të çojë në fyerje apo provokim të të tjerëve, apo të dëmtojë reputacionin e tyre nuk pajtohet me rolin e shtypit për të ofruar informacion mbi çështjet e ditës, opinionet dhe idetë”²⁷.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka përcaktuar sa më poshtë vijon në nenet respektive:

Në nenin 9, “Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë”, citohet se: “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.”

Në nenin 14, ku parashikohet “Ndalimi i diskriminimit”, citohet se: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Neni 17, “Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave”: “Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë”.

Protokolli Nr. 12, në nenin 1 “Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”, citon: “1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si

²⁶ Për më shumë informacion referoju çështjes *Engels and Others kundër Hollandës*, 1976.

²⁷ Thoma kundër Luksemburgut/64; Albert-Engelmann-Gesellschaft mbH kundër Austrisë.

seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, ka përcaktuar sa më poshtë vijon në nenet respektive:

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, referon në nenin 2 se: “1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.”

Në nenin 5, parashikohet se: “1. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njuh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt...”.

Neni 18 , thekson: “1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit. 2. Askush nuk duhet t’i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij. 3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve. 4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.

Neni 19, parashikon: “1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje. 2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij. 3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t’u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik”.

Neni 20, parashikon: “1. Çdo propagandë në favor të luftës ndalohet me ligj. 2. Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohet me ligj”.

Ndërsa Neni 26, parashikon: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër”.*

Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcakton:

Në nenin 3, parashikohen përkufizimet, duke parashikuar se:

1. *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*

2. *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.*

7. *“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga 3 një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.*

8. *“Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.*

13. *“Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.*

Neni 5, citon se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Akte dhe dokumenta të tjerë në kuadër të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara, parashtrohen si më poshtë:

- **Rekomandimi nr. R(97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrejtjes” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave):**

Termi “gjuhë urrejtjeje” do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësi kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.”

- **Rekomandimi CM/Rek(2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 mars 2010 në takimin e 1081-të të Zëvendës Ministrave):**

Komiteti i Ministrave, në përputhje me parashikimin e nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Ministrave,

Duke ditur se lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët kanë qenë për shekuj me radhë dhe vazhdojnë ende të jenë objekt homofobie, transfobie dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit edhe brenda familjes së tyre, duke përfshirë kriminalizimin, marxhinalizimin dhe dhunën, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, dhe duke pranuar se nevojiten masa specifike për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave;

.....
Duke pasur parasysh se jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më poshtë “Gjykata”) dhe juridiksione të tjera ndërkombëtare të cilat e konsiderojnë orientimin seksual shkak të ndaluar për diskriminim dhe të cilat kanë kontribuar për çuarjen përpara të mbrojtjes së të drejtave të personave transeksualë;

.....
Duke kujtuar që në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, çdo dallim në trajtim në mënyrë që të mos jetë diskriminues, duhet të ketë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të përdorë instrumente që janë përpjesëtimisht të arsyeshme me qëllimin e ndjekur;

.....
Duke mbajtur parasysh se as parimi i vlerave kulturore, tradicionale ose fetare, dhe as rregullat e një “kulture dominuese” nuk mund të përdoren si shkaqe për justifikimin e fjalimeve të urrejtjes apo të asnjë forme tjetër diskriminimi, duke përfshirë dhe orientimin seksual ose identitetin gjinor;

.....
U rekomandon shteteve anëtare:

I. E drejta për të jetuar, për siguri dhe mbrojtje nga dhuna

B. “Fjalimet e urrejtjes”

6. Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin. “Fjalimet e urrejtjes” ndalohen dhe dënohen publikisht. Të gjitha masat respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe me jurisprudencën e Gjykatës.

- **Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132):**

Në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin e llojit të përgjegjësisë, nëse ka, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, autoritetet e shteteve anëtare dhe palët e tjera të interesuara, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës, duhet të marrin të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimin ndërmjet tyre: përmbajtja e shprehjes; konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; qëllimi i folësit; roli dhe statusi i folësit në shoqëri; si shpërndahet apo përforcohet shprehja; aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.

....

Organizatat e shoqërisë civile duhet të inkurajohen të krijojnë politika specifike për të parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes dhe, kur është e përshtatshme dhe e mundshme, të ofrojnë trajnime për stafin, anëtarët dhe vullnetarët e tyre. Organizatat e shoqërisë civile duhet gjithashtu të inkurajohen që të bashkëpunojnë dhe të bashkërendojnë mes tyre dhe me palët e tjera të interesuara për çështjet e gjuhës së urrejtjes.

Së fundmi, **Këshilli i Europës** ka miratuar **Rekomandimin (2024) 4** mbi luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Në krahasim me Kartën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, Rekomandimi i Këshillit të Evropës për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (2024) 4 është një dokument që ka vlerë rekomanduese. Pra, Rekomandimi i Këshillit të Evropës për luftën kundër gjuhës së urrejtjes nuk ka detyrim ligjor për shtetet anëtare të Këshillit të Europës.

Megjithatë, ky rekomandim ka një rëndësi për arsyet e mëposhtme:

Së pari, Rekomandimi i Këshillit të Evropës për luftën kundër gjuhës së urrejtjes rekomandon shtetet anëtare për të parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes në mjediset online. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se ekziston një kuadër ligjor gjithëpërfshirës dhe efektiv, i përbërë 14 nga dispozita të kalibruara siç duhet të ligjit civil, administrativ dhe penal. Ligji penal duhet të zbatohet vetëm si mjeti i fundit dhe për shprehjet më serioze të urrejtjes. (pika 2/7).

Së dyti, Rekomandimi i Këshillit të Evropës për luftën kundër gjuhës së urrejtjes udhëzon autoritetet qeveritare, politikanët, gazetatat, agjentët online dhe grupet nga shoqëria civile për të ndaluar përhapjen e gjuhës së urrejtjes. (Këshilli i Europës. (2024).

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), ka dalë me rekomadimet si më poshtë:

- **Rekomandimi Nr. 15 i Politikës Së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015:**

Duke pasur parasysh që, për qëllimet e këtij Rekomandimi të Politikës së përgjithshme, gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e "racës"1 , ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit;

....

Duke pranuar që udhëheqësit politikë, fetarë dhe komunitarë, si dhe personalitete të tjera të jetës publike, kanë një përgjegjësi veçanërisht të rëndësishme në këtë drejtim për shkak të aftësisë për të ndikuar te një publik i gjerë;

B. Përkufizime

Terminologjia

7. Për qëllimet e këtij Rekomandimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- "avokim" lidhur me denigrimin, urrejtjen apo përgojimin nënkupton mbështetjen e shprehur, të qëllimshme dhe aktive për sjellje dhe qëndrime të tilla lidhur me një grup të caktuar personash;
- "identiteti gjinor" nënkupton e përvojën e brendshme dhe individuale të gjinisë që çdo person ndjen së brendshmi, që mund të mos korrespondojë me gjininë e përcaktuar në lindje, përfshirë ndjesinë personale të trupit (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes apo funksionit trupor me mënyra mjekësore, kirurgjikale, apo të tjera) si dhe forma të tjera të shprehjes së gjinisë, përfshirë veshjen, të folurit dhe manierizmat;
- "denigrim" nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash;
- "urrejtje" nënkupton gjendjen mendore të karakterizuar nga emocione të forta dhe joracionale mlllefë, armiqësie dhe përçmimi ndaj grupit të shënjestruar.
- "homofobi" nënkupton paragjykimet, urrejtjen apo frikën nga homoseksualiteti apo nga njerëzit që identifikohen apo perceptohen si biseksualë, homoseksualë, lesbikë apo transgjinorë;
- "nxitje" nënkupton deklarata për grupe personash të cilat krijojnë rrezik të menjëhershëm diskriminimi, armiqësie apo dhune ndaj personave të grupit/grupeve;

- *“stereotipizim negativ”* nënkupton një opinion të përgjithshëm sikur një pjesëtar apo pjesëtarët e një grupi personash kanë karakteristika të caktuara, duke i vlerësuar me negativitet, pavarësisht karakteristikave të veçanta të pjesëtarit apo pjesëtarëve fjalë;
 - *“orientim seksual”* nënkupton kapacitetin e kujtudo për tërheqje të thellë emocionale, simpatie dhe seksuale ndaj të tjerëve si dhe marrëdhëniet intime dhe seksuale me individë të një gjinie tjetër apo të së njëjtës gjini apo të më shumë se një gjinie
 - *“stigmatizim”* nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative;
 - *“transfobi”* nënkupton paragjykimet, urrejtjes apo frikën nga transeksualiteti apo personat transeksualë apo transgjiorë, bazuar në shprehjen e identitetit të brendshëm gjinor të tyre;
 - *“përgojim”* nënkupton kritikën abuzive ndaj një apo shumë personave lidhur me anëtarësinë e tyre në një grup të caktuar personash;
 - *“grupe vulnerabël”* nënkupton ato grupe që janë veçanërisht objekt i gjuhës së urrejtjes, që ndryshojnë sipas rrethanave kombëtare por që zakonisht janë azilkërkuesit dhe refugjatët, emigrantët dhe migrantët e tjerë, komuniteti i personave me ngjyrë dhe hebrenjve, myslimanët, romët / ciganët, pakica të tjera fetare, historike, etnike dhe gjuhësore, si edhe personat LGBT; në veçanti, përfshin fëmijët dhe të rinjtë që u përkasin grupeve të tilla;
- **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike - Komenti i Përgjithshëm nr. 22: Neni 18 Liria e Mendimit, ndërgjegjja ose feja, miratuar në sesionin e dyzet e tetë të Komitetit të të Drejtave të Njeriut, më 30 korrik 1993:**

Në përputhje me nenin 20, asnjë manifestim i fesë ose besimit nuk mund të përbëjë propagandë për luftë ose mbrojtje të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë. Siç deklarohet nga Komiteti në komentin e tij të përgjithshëm nr. 11 [19], shtetet palë janë të detyruara të nxjerrin ligje për të ndaluar akte të tilla.

- **Progres Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2021, publikuar në 19 tetor 2021.²⁸ Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut:**

Rastet e agresionit fizik ndaj anëtarëve të komunitetit ende ndodhin dhe gjuha e urrejtjes vazhdon, veçanërisht në mediat sociale.

Ndërgjegjësimi publik dhe pranimi i personave LGBTIQ mbetet i ulët, veçanërisht në zonat rurale. Gjuha e urrejtjes dhe gjuha diskriminuese vazhdojnë të jenë problem në media, veçanërisht mediat online, dhe nga politikanët. Dhuna dhe diskriminimi ndaj pjesëtarëve të komunitetit është ende një fenomen shqetësues në vend.

- **Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i gjashtë monitorues), miratuar më 7 prill 2020²⁹:**

ECRI rekomandon që autoritetet të marrin frymëzim nga rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr.15 i ECRI-t për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe të dënojnë me forcë dhe

²⁸ Faqe 34, e variantit në anglisht të Progres Raportit.

²⁹ Faqe 17 e Raportit, në variantin e gjuhës shqipe.

publikisht incidente të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht kundër personave LGBTI dhe romë. Ata gjithashtu duhet të inkurajojnë figura të tjera publike të dënojnë veprime të tilla dhe të përfshihen në kundërpërgjigje.

- **Raport “Mbi diskriminimin dhe dhunën ndaj individëve bazuar në orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor”, të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, viti 2015³⁰**

Një nga rekomandimet në këtë raport është ndalimi i nxitjes së urrejtjes dhe dhunës për shkaqe të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si dhe llogaridhënia e personave përgjegjës për gjuhën e urrejtjes.

- **Raporti i Komisionit Evropian, për Shqipërinë, publikuar më datë 31.05.2023³¹:**

Përsëritet planin e veprimit 2021-2027 për personat LGBTI në Shqipëri dhe bën thirrje për zbatimin e tij; përsëritet suksesin e paradës së 11-të të Krenarisë së Tiranës në 2022; u bën thirrje autoriteteve të miratojnë legjislacionin për njohjen e identitetit gjinor dhe partneriteteve dhe/ose martesave të të njëjtit seks; shpreh shqetësimin e tij serioz për diskriminimin ndaj personave LGBTIQ+ në lidhje me aksesin në kujdesin shëndetësor, arsimin, drejtësinë, punësimin dhe strehimin; dënon rastet e agresionit fizik dhe gjuhës së urrejtjes kundër komunitetit LGBTIQ+.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, dhe të Planit të saj të Veprimit”:

E konceptuar si vijim dhe e lidhur logjikisht me Strategjinë e mëparshme për Barazinë Gjinore 2016-2020³², “SKBGJ 2021-2030” përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t’u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikrat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cënueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e

³⁰ A/HRC/29/23, 4 maj 2015, pika 78.

³¹ Faqe 13 e Raportit, përkthim i Komisionerit.

³² <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.

“SKBGJ 2021-2030” është e katërta e këtij lloji dhe padyshim reflekton (sikurse dhe strategjitë e mëparshme), përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që Qeveria e Shqipërisë i kushton arritjes së barazisë gjinore, si dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Në të gjithë dokumentin strategjik dhe planin e veprimit të SKBGJ 2021 – 2030, theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, azilkërkuese, etj, pra nga të gjitha grupet në shoqëri.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.2021 *“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, dhe të Planit të saj të Veprimit”*:

E konceptuar si vijim dhe e lidhur logjikisht me Strategjinë e mëparshme për Barazinë Gjinore 2016-2020³³, “SKBGJ 2021-2030” përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t’u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cënueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.

Në të gjithë dokumentin strategjik dhe planin e veprimit të SKBGJ 2021 – 2030, theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grupeve të cënueshme e që pësojnë diskriminim si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, azilkërkuese, etj, pra nga të gjitha grupet në shoqëri.

Një nga qëllimet strategjike të këtij dokumenti është edhe zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, duke parashikuar:

³³<https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Edhe për përmbushjen e këtij qëllimi strategjik janë parashikuar objektiva specifike të bazuar në SKBGJ 2016-2020 duke shtuar dhe theksuar domosdoshmërinë e ndëshkimit dhe rehabilitimit të dhunuesve, shtimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbështetjen e të mbijetuarave deri në riintegrimin e tyre.

Plani Kombëtar të Veprimit (PKV) për komunitetin LGBTI (2021-2027)

“PKV LGBTI+ 2021 – 2027” lidhet drejtpërdrejt me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II 2015-2020³⁴, me Programin Qeverisës 2017-2021³⁵, me plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm³⁶ (OZHQ) dhe me Axhendën 2030³⁷. Në masa apo veprime të caktuara të “PKV LGBTI+ 2021 – 2027” është mbajtur në konsideratë dhe është bërë referencë edhe në “Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 20231 – 2030”³⁸, si dhe në Strategjinë e Komisionit Evropian “Bashkimi i Barazisë: Strategjia e Barazisë për LGBTIQ 2020-2025”, e para strategji e Komisionit për barazinë e LGBTIQ, publikuar më 11 nëntor 2020³⁹.

“PKV LGBTI+ 2021 – 2027” është i treti plan veprimi në nivel kombëtar me fokus mbrojtjen e të drejtave, ofrimin e shërbimeve cilësore, rritjen e ndërgjegjësimit dhe zvogëlimin e nivelit të papranueshmërisë së shoqërisë kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri. Si i tillë ky PKV reflekton përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që Qeveria e Shqipërisë i kushton krijimit të një shoqërie në themel të së cilës qëndron e drejta, merita dhe vlerat qytetare, sociale e profesionale e çdo individ, si dhe qeverisja në mënyrë të përgjegjshme, efikase, transparente, në interes të zhvillimit të vendit, duke luftuar korrupsionin, pabarazinë përpara ligjit, pandëshkueshmërinë apo diskriminimet e çdo lloji qofshin.

Miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për komunitetin LGBTI (2021-2027) pohon angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të zhvilluar më tej programin e saj për të garantuar barazi dhe mbrojtje për komunitetet vulnerabël, në përputhje me standardet dhe vlerat evropiane. Ai bazohet në analizën gjithëpërfshirëse të punës së kryer mbi Planin e Veprimit të mëparshëm, duke ruajtur një qasje të synuar bazuar në nevojat specifike të komunitetit LGBTI shqiptar.

Plani i Veprimit synon të sigurojë një shoqëri gjithëpërfshirëse, jo-diskriminuese dhe të sigurt për personat LGBTI në Shqipëri, me akses më të mirë në shërbimet publike dhe mbështetje të specializuar, përmirësim të kuadrit ligjor dhe zbatimit, si dhe rritjes së aksesit në sistemin e drejtësisë të personave LGBTI.

³⁴ https://www.mod.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf

³⁵ <https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf>

³⁶ <https://sdgs.un.org/goals>

³⁷ <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20ëb.pdf>

³⁸ Miratuar me VKM nr. 400 datë 30.06.2021 botuar në Fletoren Zyrtare Nr.112, datë 15.07.2021

³⁹ https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/lesbian-gay-bi-trans-and-intersex-equality/lgbtiq-equality-strategy-2020-2025_en

Në betejën kundër stereotipeve dhe qëndrimeve paragjyquese patriarkale, Plan i Veprimit përcakton nevojën për angazhimin e burimeve të ndryshme dhe marrjen e një sërë veprimesh të mirëkoordinuara midis të gjithë aktorëve kryesorë që synojnë ndryshimin rrënjësor të mentalitetit në shoqërinë tonë. Ai fokusohet tek informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi për të pranuar të gjithë ashtu siç janë dhe siç ndihen përsa i përket identitetit të tyre gjinor ose orientimit seksual.

“PKV LGBTI+ 2021 – 2027” harmonizohet edhe me Strategjinë e Komisionit Evropian “Bashkimi i Barazisë: Strategjia e Barazisë për LGBTIQ 2020-2025”. Ky harmonizim vërehet kryesisht në:

“Shtyllën 1 “Ndalimi i diskriminimit ndaj personave LGBTIQ”, e në mënyrë specifike në 1.1. Zbatimi dhe përmirësimi i mbrojtjes ligjore kundër diskriminimit; 1.2. Promovimi i përfshirjes dhe diversitetit në vendin e punës; 1.3. Luftimi i pabarazisë në arsim, shëndetësi, kulturë dhe sport.

Shtyllën 2 “Garantimi i sigurisë për personat LGBTIQ”, e në mënyrë specifike në 2.1 “Përforsimi i mbrojtjes ligjore për personat LGBTIQ kundër krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës”;

Shtyllën 3: “Ndërtimi i shoqërisë gjithëpërfshirëse për personat LGBTIQ”, e në mënyrë specifike me 3.3 “Përmirësimi i njohjes së identiteteve trans dhe jo binare, si dhe i personave interseks” “.

Dokumenti ndër të tjera, evidenton se: *“Ndërgjegjësimi dhe pranimi nga ana e publikut i personave LGBTI+ mbetet në nivel të ulët, veçanërisht në zonat rurale. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese vazhdon të jetë një problem në media, veçanërisht në media online. Dhuna dhe diskriminimi kundër personave transgjinorë është një fenomen shqetësues në vend.*

Raporti i Rishikimit Universal Periodik për Shqipërinë 2019⁴⁰, përmban një tërësi rekomandimesh, ndër të cilat më të rëndësishmet lidhur me personat LGBTI+ renditen:

- Përmirësimi i përpjekjeve për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+, veçanërisht rishikimi i kurrikulave akademike mbi stereotipet gjinore dhe identitetin gjinor, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm 5 dhe 10;*
- Forcimi i politikave për të luftuar veprat e dhunshme dhe krimet e urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, duke krijuar lidhje më të qendrueshme me shoqërinë civile dhe duke garantuar zbatimin e dispozitave ligjore për krimet e urrejtjes;*
- Mbrojtja e personave LGBTI+ nga stigma dhe diskriminimi në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor, ndër të tjera, nëpërmjet trajnimeve për të gjithë personelin shëndetësor për të drejtat dhe rëndësinë e qasjes së barabartë të personave LGBTI+ në kujdesin shëndetësor;*
- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut të personave LGBTI+ duke luftuar diskriminimin strukturor;*
- Zhvillimi i programeve në shkolla për të eliminuar ngacmimet ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve LGBTI+ dhe zbatimi i masave mbështetëse psikologjike për të zvogëluar përqindjet e braktisjes së shkollës nga ana e tyre;*
- Ndryshimi i Kodit të Familjes për të siguruar njohjen ligjore për çiftet e të njëjtit seks dhe miratimin e dispozitave që lejojnë njohjen ligjore të gjinisë së individëve trans; etj.”*

⁴⁰ <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALIndex.aspx>

Parimet kryesore që udhëheqin “PKV LGBTI+ 2021-2027” janë:

- Parimi për të gëzuar universalisht të drejtat e njeriut.

Të gjitha qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta. Qeniet njerëzore të të gjitha orientimeve seksuale, të të gjitha shprehjeve të identiteteve gjinore, të të gjitha karakteristikave të seksit apo tërësisë së karakteristikave të tjera individuale, kanë të drejtën e gëzimit të plotë të të gjitha të drejtave të njeriut.

- Parimi për të gëzuar mbrojtje nga shteti.

Të gjithë personat në një shoqëri, pavarësisht nga orientimi seksual, shprehja e identitetit gjinor, karakteristikat e seksit, apo karakteristika të tjera individuale, kanë të drejtë të gëzojë mbrojtjen e shtetit nga dhuna, diskriminimi dhe dëmtime të tjera, qoftë nga ana e punonjësve apo punonjësve të shtetit, qoftë nga ndonjë individ apo grup i caktuar.

- Parimi i mosdiskriminimit si pikënisje bazë në ofrimin e shërbimeve.

Të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtë për trajtim të barabartë pavarësisht nga mosha, gjinia, raca, feja, kombësia, etnia, orientimi seksual, shprehja e identitetit gjinor, karakteristikat e seksit apo çdo karakteristikë tjetër. “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi⁴¹.

- Parimi i afirmimit/pohimit dhe respektit për identitetin personal.

Afirmimi është një mënyrë e të kuptuarit dhe të krijuarit të hapësirave të sigurta për të gjithë njerëzit. Afirmimi është i rëndësishëm gjatë gjithë jetës. Personat LGBTI+ shpesh kanë frikë se mund të abuzohen ose se nuk do të mund të marrin kujdes sipas standardeve nëse janë të hapur për identitetin e tyre. Kjo frikë mund t'i shtyjë ata të fshehin orientimin seksual ose identitetin gjinor, duke i shkëputur kështu nga komuniteti i tyre dhe nga afirmimet e rëndësishme për historinë dhe përvojën e tyre. Përqendrimi në afirmim na lejon të kuptojmë se çfarë mund të bëjë mungesa e tij për ndjenjën e vetvetes të një personi dhe cilësinë e kujdesit të tij - veçanërisht kur njerëzit rriten dhe kanë nevojë për marrëdhënie të reja dhe forma të ndryshme të kujdesit⁴². Pra, koncepti i afirmimit është një formë aktive e shprehjes së identitetit dhe në kontekstin e personave LGBTI+

⁴¹ https://www.uart.edu.al/media/150329-Ligji%2010221_%202010%20per%20mbrojtjen%20nga%20%20diskriminimi.pdf

⁴² <https://scholars.org/contribution/affirmation-way-understand-and-create-safe-spaces-all-people>

ai lidhet sidomos me problematikën e “fshehjes” së tyre apo statistikave rreth tyre, në shërbime të ndryshme.

“PKV LGBTI+ 2021-2027” përbëhet nga 3 (tre) Qëllime Strategjike, si më poshtë citohen:

- Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specifike të tyre dhe me standarde kombëtare të harmonizuara me ato evropiane/ndërkombëtare.
- Garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë për personat LGBTI+ përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, zbatimit efektiv të tij, si dhe rritjes së aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë.
- Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jo-diskriminuese kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri

Ky dokument vë theksin gjithashtu tek domosdoshmëria e bashkëpunimit mes shumë aktorëve institucionalë dhe jo vetëm, duke cituar se: *“ Arritja e këtyre qëllimeve strategjike kërkon përpjekje të gjithanshme nga të gjitha ministratë e linjës, institucionet publike qendrore, në nivel qarku e vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile sidomos ato të specializuara në çështjet LGBTI+, organizatat ndërkombëtare, medias, akademisë, si dhe të të gjithë aktorëve të tjerë që zbatojnë politika të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në garantimin e të drejtave të personave LGBTI+ ”.*

IV. Vlerësimi dhe analiza e fakteve, provave dhe rrethanave të çështjes.

Sipas GJEDNJ-së, sulmi kundër reputacionit të personit/personave duhet të arrijë një nivel të tillë të rëndë, në mënyrë që të shkaktojë paragjykim të gëzimit të së drejtës së respektimit të së drejtës nga individ/individët. Gjuha e urrejtjes konsiderohet e tillë edhe kur efekti që ajo prodhon, krijon pritshmërinë se mund të nxisë drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit armiqësisë apo diskriminimit.

Për të vlerësuar nëse ekziston rreziku që aktet e promovuara ose të nxitura nga gjuha e urrejtjes të ndodhin, Komisioneri ka marrë në konsideratë rrethanat e mëposhtme, në përputhje me frymën e Rekomandimit Nr. 15 të ECRI-t.

Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi shprehjet e kontestuar janë realizuar nëpërmjet fjalëve të deklaruara dhe në mënyrë publike, pasi janë bërë në platforma mediatike online, you tube dhe televizione, platforma këto, të cilat përfshihen në mjetet e përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

Pala ankuese ka evidentuar 9 (nëntë) dalje, pjesëmarrje të znj. D. M (qëndrimin, shprehjet dhe deklaratat e bëra prej saj), në emisionet ku ka qenë e ftuar, për periudhën nga Maji 2024 – Janar 2025.

Komisioneri thekson se, në pasazhet e evidentuara, pjesa e nënvizuar paraqet pretendimin e Qendrës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”, për përdorim të gjuhës së urrejtjes nga znj. D. M.

Ndërsa pjesa tjetër, evidentuar në mënyrë më të zgjeruar është depozituar si provë nga znj. M, për të prapësuar se deklaratimet, gjuha dhe shprehjet e përdorura prej saj nuk kanë qëllimin të diskriminojnë askënd, dhe se ato janë shkëputur në mënyrë të tillë qëllimisht nga pala ankuese, duke i nxjerrë nga konteksti, duke i deformuar e ndryshuar ato.

Sa më sipër, faktet e prezantuara nga të dyja palët paqyrohen si vijon:

1. Televizioni Abc News - Emisioni: Bardh a Zi - Data: 22 Maj, 2024

Link: <https://www.youtube.com/watch?v=WTepZ8KyZp0&t=2518s>

Gazetarja: Unë do të flas si nënë tani dhe do t'i kthejmë të gjithë sytë te ajo foto.

E. T: Fol edhe si baba, mos fol vetëm si nënë.

Gazetarja: Jo jo, si nënë do të flas.

D. M: (minuta 1:40 “E drejta e babit është hequr aty, nuk flasim, ule karrigen pastaj ngrije

E. T: Jo jo, se ul (Qesh)”

.....

E. T: Shqetësimi im është ky: Apo rriten fëmijë gay? A kanë të drejtë këto zonja të rrisin shijet etyre te fëmijët e tyre?(minuta 4:3)

Gazetari: T'i dëgjojmë edhe kolegët.

D. M: Kemi një video në rrjetin tim social, ku një grua i është shprehur Lindës që ka fëmijë gay dhe ka qenë një diskutim shumë i flaktë dhe shumë kundërshtues nga ndjekësit.

(minuta 5:10 “A ka fëmijë gay? Kjo ka qenë pyetja. Asnjë prind nuk donte që fëmija të prekej, pra familja të prekej nga fenomeni i gjenderizimit. Nuk duan, në Shqipëri nuk duan. Pra, unë po votoj, ka polls aty tek faqja ime dhe po votojmë, po shikojmë.

Ju mos u çudisni që po puthen dy vajza atje, sepse jeni ju dhe shoqëria dhe unë, të gjithë, i kemi pranuar”.

Ka qenë një luftë nga vitet 2000 deri në vitet 2015, në mos gaboj, dhe në vitin 2015-2020 u normalizua në rrjete sociale, në shoqëri, në profesione të ndryshme, na shërbenin, i kemi shërbyer, pra, kemi pasur marrëdhënie sociale, kulturore me ta dhe dy vajzat.

Pra, kemi shkëmbyer marrëdhënie shoqërore me ta, dhe ne s'kemi pse cuditemi pse dy vajza puthen, se ato bashkëjetojnë. Ato nuk gënjejnë, ato e kanë bëtë këtë më përpara, por ato duan ta kurorëzojnë. Unë mendoj që nuk janë dy vajzat që e kanë bërë atë jetë më përpara, ne nuk duhet të merremi me dy vajzat. D nuk merret me dy vajzat.

Ne s'kemi koalicion, ne merremi me fenomenin që është i sforcuar për të dalë tek ai ligj që na ka ardhur, na ka trokitur. Një ligj që i ngjan shumë ligjit liberal të Kanadasë, ku ne llahtarise mi se c'po bëhet me fëmijët.

Dalim tek pyetja dy: (minuta 6:35 “A ka fëmijë gay? Fëmijët nuk janë gay. Se jemi ne të rritur, kemi kaluar një fëmijëri dhe nuk kuptonim çfarë ishte, por ishim në një marrëdhënie shumë të pastër. Dhe njeriut, qënies njërëzore, i shkon të ketë edhe një jetë private, të pa prekur dhe të

pacenuar nga një grup që troket, si ai ujku te kecat dhe thotë: ‘Më falni, a doni leksione për gejllek dhe gjenderizim? Po ju, a doni sorrogaci? Ne kemi çdo datë një, në maj, çdo vit, vihet dhe thuhet: A keni djem për ti bërë gay? A keni surrogaci? – na thanë këtë vit.

Por jemi të lodhur, jo... sepse bota nuk po vjen duke u lumturuar, por bota po vjen duke u shkatërruar. Kush na ruan nga shkatërrimi? Familja. Të gjithë duhet të struken tek familja, sado me probleme dhe e vogël të jetë”.

Gazetarja: Tani, këto modele janë të shëndosha?

D. M: Këto modele nuk janë të shëndosha në këtë moment ku jemi në shoqëri. Pra, dy vajzat nuk po gënjejnë, e kanë bërë dhe ne, nuk merremi dot me dy vajzat dhe nuk kemi të drejtë të hyjmë në jetën e tyre personale, sepse vetë i kemi pranuar në shoqëri. Për fëmijët jo, për fëmijët jo.

.....

D. M: A ta bëjmë një meme, se vdesin për meme shqiptarët.

(minuta 24:20) “Kam kaq kohë që po kërkoj kromozomin “no gender” në biologji. A kam lënë bibliotekë pa bredhur? Po ma nxirrni more atë kromozon, si e ka fytyrën që ta shikoj kromozonin “no gender”, sepse njohim vetëm xx, xy. Dhe si ndihesh ti, nuk më bëhet vonë fare, se ti, mund të ndihesh edhe si një person që do të bësh “pipinë” në rrugë. Po nuk më bëhet vonë dhe nuk duhet të ndikojë fare tek pjesa e masës, e edukimit, shkollimit.

Ne nuk i mësojmë shkencën fëmijëve në shkollë dhe duhet t’i cojmë në një program: “Si ndihesh ti?” Ne duhet të luftojmë bullizmin, të bëjmë programe për të luftuar bullizmin. Por, si ka mundësi që këta njerëz thonë që kemi ligjin e diskriminimit?

O na kanë diskriminuar ne të fitness-it, ne nuk këkuam asnjë ligj diskriminimi! Jo po si burrë, jo po me muskuj...pamë jetën tonë, duruam. (minuta 25:11) “Ti që e kërkon atë jetë, ti që vishesh si trans, ti e ke menduar që dikush do ta thotë një fjalë, po mbaje mbi kurriz, se atë po kërkon”

E. T: Dhe ti e ke menduar që po bëhesh bodybuilder, të gjithë e kanë menduar.

D. M: Po po, dhe unë kam kërkuar një ligj diskriminimi?! Madje as nuk kam replikuar, se thashë: “Këtë punë paskan...” dhe kjo është një zgjedhje sepse nuk e kuptojnë. Unë nuk kam kërkuar kurrë ligjin që e gjithë botëa, sic po e shohim në Perëndim, të bëhet gay ose lesbike. (minuta 25:32) Nëse dikujt i pëlqen fitnessi, ai e ndjek, është një zgjedhje personale, varet nga si ndihesh.

Nëse vajza ime e fejuar bën një fëmijë, pas pesë vitesh, bazuar në ligjet aktuale, unë mund të përfundoj në burg. Sipas ligjeve të Trudeau-s, gjuha e urrejtjes dënohet me burgim të përjetshëm, që do të thotë se pas pesë vitesh, unë do të isha duke vuajtur një dënim prej 250 vitesh.

.....

Pra, ne po flasim për të drejtën private. Pse ndryshon nga e drejta publike? (minuta 27:36) “Këto të drejtën private po ia imponojnë publikut dhe kjo është ajo që ne kundërshtojmë. Mos impononi! Unë pranoj që vajzat të bashkëjetojnë.

Gazetari: Mesa kuptova unë në një komunikim që pata, ideja e tyre ishte që: “Pse, kur martohesh ti, më pyet mua?! Jo! Edhe unë, kur të martohem s’kam pse të të pyes ty!” d.m th kjo ishte ideja. Pra, duhet ta them sic e kanë thënë ata, që të jem i saktë.

.....

(Minuta 28:27) “Po sjellin frymën e gjenderizimit te fëmijët. Sepse ku është futur? Ne e shikojmë që në të njëjtin muaj është tundur Shqipëria, sepse na ka ardhur dhe ligji, ku këto ndryshime ishin

bërë me kërkesë të organizatës, Aleancës LGBT. Këta kishin sjellë kërkesën për ndryshimin e rregullimit të shëndetit seksual të fëmijëve, të rinjve, të moshës së re”

Minuta 28:27 “Po çfarë prek ajo? (kërkesa e supozuar e Aleancës LGBT) Ajo prek brezin e ri. Çfarë prek? Familjen e re, pleqërinë tonë dhe familjen e re. Ai është projekt, ai është projekt i mirëmenduar. Pse? Se i ngjan programit pilot në Kanada, është program pilot lart në perëndim dhe ne jemi vende eksperimentale”

.....

D. M: Atëherë, flasim për sterilizimin. Mosha nën 18 vjeç ishte me komision dhe me prind. Ndërsa të djemtë, këtu ndalojmë te pjesa e burrërisë. Dhe pse burrëria? Sepse shikojmë që po sulmohet vitet e fundit. Burrëria është kryengritja e së drejtës.

Çfarë do të bëjnë vajzat e shkreta me disa djem që janë të tredhur? Le të flasim për Shqipërinë, sepse Shqipëria është e njohur për burrërinë, dhe këta do të kenë të pamundur ta shkelin burrërinë e Shqipërisë. Ose do të bëhemi ne gratë burra pastaj! Ka burra këtu, nuk ka vdekur ky vend. O zotëri, do ta kishin kaluar ligjin po ta kishin kaq të lehtë me Shqipërinë!

E. T: Lëre mos e pyet! Shqipëria është vend shumë i vështirë për të bërë gjëra.

D. M: (minuta 29:29) Këta janë skutha, sepse nuk i hedhin nëpër referendume. Çfarë është demokracia?!

.....

D. M: (minuta 30:31) Sterilizimi nën moshën 23 vjeç ishte normalisht me praninë e një komisioni, por ai ishte një komision i papërcaktuar. Nuk kemi një kalë të Trojës, nuk kemi një moshë të përcaktuar si tavan dhe dyshe.

Ata mund të ndërhyjnë dhe tek 15 vjeçarët, edhe te 16 vjeçarët. Dhe ky komision, kush është? Si ajo Ministria që na e përcolli vendimin pa thënë asnjë presje? Flasim në fund, flasim në fund, dhe kur erdhi momenti tha: “*Më falni se më ka ardhur një takim*”. Kjo ishte mungesë respekti. Ju keni zaptuar një tavolinë që nuk e meritoni. Nëse nuk e bëni dot punën, lironi tavolinën! Shporruni që këtu!

Po tradhëtohet kombi! Sepse të gjitha pikat prekin trashëgiminë kombëtare! Dhe çfarë bëjnë ata në shtëpi, janë të lirë, kanë mbështetjen tonë, kanë respektin tonë, janë pjesë e komunitetit.

.....

D. M: (minuta 31:18) “Ata nuk mund të vendosin dot për shumicën dhe të prekin edhe komunitetet fetare, edhe respektin e nënës! Ata po degjenerojnë nënën me surrogacinë! Sepse femra shqiptare po mban mbi kurriz gjithë këtë.

Dhe çfarë i thotë Evropa për vitet e prostitucionit? Ky është turpi më i madh! Nuk duhet ta lejojmë! Sepse femrat shqiptare, nënat shqiptare që na kanë rritur, nuk meritojnë fjalën surrogaci! Nëse një nënë baba do të marrë një fëmijë nga një grua tjetër, le të quhet birësim! Le të quhet fëmijë i falur, sic është quajtur më përpara. ...Mitra është vazhdimësia e tokës! Është Zoti! Vazhdimësia është Zoti! Dhe këta po sfidojnë Zotin!”

.....

D. M: (minuta 37:04) E dini pse s’jam martuar unë? Ishte një intervistë me R.D, në mos gaboj, dhe më tha: Pse s’u martove ti? Ke qenë një nga vajzat e showbizit! Sepse njeriu gjithmonë ka atë tendencën e kuriozitetit.

Unë ia kam kushtuar jetën vajzës time. Kur u martua ish-bashkëshorti im, vajza erdhi dhe qau në shtëpi. Kishte atë xhelozinë e saj, ishte vetëm 13 vjeç. Sot, ne shkojmë shumë mirë dhe me ish-bashkëshortin, dhe me gruan e tij. Unë shkoj shumë mirë me të. Por asokohe, vajzës i dridhej buza, i dridhej mjekra...kishte qarë fshehurazi.

I thashë: Cfarë ka ndodhur? Mendova gjëma, drama. Më tha: “Ti do të martohesh si babi?” Dhe unë gjithmonë i kam mbajtur premtimet.

Ndoshta vonë, sepse nuk e kemi pasur mundësinë ekonomike gjatë gjithë kohës, por kurrë nuk e kam gënjyer. Dhe ajo, vetëm këtë mban mend: Mami kurrë s’më ka gënjyer! Fëmijët janë të fiksuar pas premtimeve!

Gazetarja: Po ti i premtove që jo?

D. M: Kurrë s’do të martohem! – i thashë. Kur të duash ti. 20 vjec- më tha ajo, dhe, kur mbushi 20 vjec, më tha: Tani mund të martohesh!

.....

D. M: (minuta 38:26) “E di çfarë janë këto bebe që këta ia heqin gjirit të nënës dhe ia çojnë dy burrave trans? A dinë këta çfarë po prekin?! Ky është buton i kuq i Krijuesit. Nuk mund ta prekësh butonin e kuq të Krijuesit, sepse do sillnim fundin. Ky është fundi”.

2. Podcard – ShpresON - Platforma You Tube - Data:16 Maj, 2024

Link: <https://www.youtube.com/watch?v=arma8rmë8Wc&t=610s>

(Minuta 50:00 – 50:34) D. M: Nuk e kuptoj si mund ta quajnë homofob një person që thjesht shpreh mendimin etij se këta njerëz nuk duhet të futen në shkolla, sepse fëmijët duhet të ruajnë pastërtinë dhe sinqeritetin e tyre.

Av. A. G: Në këndvështrimin tim, cdo njeri ka të drejtë ta jetojë jetën sic dëshiron dhe të sillet sipas natyrës së tij, por askush nuk ka të drejtë t’u afrohet fëmijëve.

D. M: Pra, këta thonë: “Ti mund të adoptosh si të duash, kur të duash. Kur e ke nëntë muaj në bark është i yti, por sapo lind është i yni”. Jo! Fëmija i përket prindërve të tij!

Av. A. G: “Eshtë bërë një biznes!”

Minuta 50:08 D. M: “Dhe pjesa që paska nisur, unë nuk e dija atë, paska nisur që shkojnë në shkolla, po normal nuk janë si ato foto që kisha postuar unë me drag queen, me figurën e djallit. Pra, një drag queen shkon e veshur si djall te fëmijët”.

Prindërit janë lebetitur dhe unë kam një video në rrjetet sociale ku tregohen prindër që kanë marrë fëmijët e tyre nga Kanada dhe janë larguar për në Rusi.

3. Podcard - ShpresON - Platforma You Tube - Data:18 Maj, 2024

Link: <https://www.youtube.com/watch?v=ds7XKGcPG6s>

Minuta 12:30 “Unë kam kohë që po paralajmëroj që po, po ... po vjen, po afron fryma e perëndimit. Që i kanë marrë fëmijët nga shkolla, i kanë injektuar hormone, ia kanë kthyer në trans”.

Minuta 30:30 “E di kush janë homofob për ta? Jemi ne që i ndalojmë, të kalojnë të kontrollojnë fëmijët tanë, për të kaluar në kampet naziste të axhendës dhe planit të tyre për botën Sodom e Gomorra”.

“...një sekondë, një sekondë, Dita Ndërkombëtare kundër Homofobisë! Nga ka ardhur termi “homofobi”? Për njerëzit normalë, për ata që duan familjen dhe traditën. Cili është krimi ynë?

Edhe unë kam shokë, po edhe për ato dy vajzat, por le të jetojmë bashkë – pse, a është kjo homofobi?!”

Av. A. G: “Jo, dhe unë them që dy meshkuj mund të jetojnë gjithë jetën bashkë, problemi është....”

D. M: “E di kush janë “homofobët” për ta? Jemi ne, ata që i ndalojmë të vijnë dhe të kontrollojnë fëmijët tanë. Të na cojnë në kampet naziste të agjendës dhe planit të tyre për një botë si Sodoma dhe Gomorra....Por kjo ka marrë fund!”

4. Tv Top Channel - Shqipëria Live - Platforma You Tube - Data: 24 Dhjetor 2024

Link: <https://www.youtube.com/watch?v=4gD8T8t3Oo8>

Nga debati, evidentohet:

Minuta 1:22-2:55: Po ku ka fëmijë trans? Ku i krijuat ju këto fëmijë trans? Nuk e ka parë historia që të ketë fëmijë trans.Nëse ekzistojnë fëmijë trans atëhere ekziston pedofilia. Pedofilia s`do lejohet kurrë nga ne. Nuk ka fëmijë trans⁴³!

Minuta 3:10-4:40: I drejtohet aktivistit LGBTI+ dhe më pas lëvizjes LGBTI+: Ti je linja e Kamalës. Ti je për psikolog...Ti je linja ku fëmijët bëhen transa. Çfarë doni jut e fëmijët e prindërve? Çfarë kërkonin nga fëmijët? Ju në Shqipëri s`do arrini dot kurrë të prekni fëmijët.

5. Tv Top Channel - E diell - Platforma You Tube - Data: 12 Janar 2025

Link: <https://www.youtube.com/watch?v=1azbJvWN9WA>

D. M: Amberi (pesonazh publik që ka pranuar haptazi ndrrimin e gjinisë së saj, nga burrë në grua) ka kërkuar gjithmonë të pranohet Amber, dhe jo Bernardi (personazh publik në një show televiziv, reality show) që thotë unë dua të ndryshoj shoqërinë. Bernardi duhet të kuptojë që shoqëria ka diversitet. Dhe konservatorët kanë të drejtat e tyre, dhe tradita shqiptare ka të drejtën e vet. Nuk i jap të drejtë aspak atyre që shajnë....shqiptarët duhet të jenë më të përmbytshëm kur shprehen për dikë...

Unë pyes një mikun tim gay...pse nuk shprehesh si Bernardi...kemi dhe gay konservatorë, ka shumë gay konservatorë...

Unë nuk shprehem sepse aty mund të më shikojnë fëmijët, pra, ky është një respekt ndaj fëmijëve, një respekt ndaj komunitetit, një respekt ndaj komuniteteve të tjera fetare, një respekt ndaj klerikëve, një respekt ndaj fëmijëve të vegjël që mund të kenë një telefon në dorë dhe mund të jenë

⁴³Për analogji citojmë vendimin nr. 108, datë 21.08.2019.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

në televizor, respekt edhe ndaj atyre që ne mund t'i quajmë homofob... Unë nuk jam homofobe, unë të thashë kam miq gay, por më pëlqejnë shumë zbatimet e kufijve.

Minuta 1:48: Unë kam shok gej konservatorë të cilët të qenurin gej e shikojnë si një problem të tyrin personal....në jetën publike japin vlerat publike, japin kontributin e tyre publik, profesional, mund të bëjnë dy-tre punë që të përballojnë jetesën, ama...nuk bëhen pjesë e një axhende për të transformuar dhe degjeneruar të gjithë njerëzit, sikurse e kemi parë që ishte një zinxhir i frikshëm në një rrymë politike globale liberale.

Dhe ne sot e bëjmë këtë dallim Dhe unë do doja shumë që shqiptarët ta bëjnë këtë dallim. Ne duhet ta respektojmë këtë komunitet të vogël që është sepse është midis nesh, ka qenë gjithmonë, por, duhet të bëjmë dhe dallimin kush do t'i japë nuancat e një lufte konservatore.

Nuk janë konservatorë ata që shajnë dhe e ofendojnë një njeri që shpreh veten. Konservatorë janë ata që arrijnë të bëjnë dallimin midis një të drejte personale dhe dikujt që kërkon të nderhyjë në shoqëri me dhunë, që kërkon të japi një shtysë të drejtave të Kodit Familjar dhe për ta transformuar atë në favor të kësaj pakice. Ne nuk mundemi të shkatërrojmë një Kod Familjar për këtë pakicë.... Sepse jemi ne konservatorët që...nënë, baba, kemi lindur këta fëmijë...Këta fëmijë kanë një disbalancë hormonale... mund të ndjehet një djalë me dashuri në vetvete për t'i dhënë dashuri një djali tjetër...e ka zgjedhur atë rrugë, e ka zgjedhur atë sfidë, se nuk është e lehtë.

As e Amberit nuk është e lehtë...që të bësh një operacion plastik në fizik...nuk është e lehtë...absolutisht kërkojnë dhe mbështetjen ...mbështetja e vetme është nëse ti nuk e pëlqen, nuk e do, mos e ofendo.

Dhe unë mendoj që do krijojmë një balancë midis komuniteteve...një marrëveshje midis komuniteteve, dhe nuk do t'i shtyjme këta individë që të shkojnë të bëhen pjesë e një agjende që i gënjen se do i mbrojtë. Por, le të qëndrojnë në konservatorizëm, le të qëndrojnë të pragu i familjes, le të qëndrojnë në gjirin e komunitetit të tyre, po pa dhunë.

.....

D. M: Biologjikisht...është fusha ime. Biologjikisht janë ndryshe (i referohen personave trans, në bisedë me të ftuarit e tjerë në panel) në marrëdhëniet seksuale.. plus minusi- të lutem, plus minusi është femër – mashkull...Biologjikisht ata vetë e kanë thënë, vetë e kanë pranuar që kemi një disbalancë hormonale. Shiko, është ok! – kjo ekziston

....

Minuta 7:22-9:30: Personat LGBTI+ biologjikisht janë ndryshe. Vetë e kanë pranuar që kanë një disbalancë hormonale. Ti nuk e mohon dot biologjinë. Të gjithë këta “no-gender” e mohojnë biologjinë. Të drejtën personale mbaje për vete. Pse duhet të shkosh me një axhendë për të shtyrë popullin, për të shkuar në shkolla? Kush ta jep ty të drejtën të futesh te fëmijët?

6. Tv Klan Plus - Shije shtëpie - Platforma You Tube

Link: <https://www.youtube.com/shorts/9Z6qS3fuxLE>

Kohë zgjatja e tërë materialit të vënë nëdispozicion nga pala ankuese është 56 sekonda, në të cilin pasqyrohet një debat mes znj. D. M dhe të ftuarës tjetër në këtë emision znj. S. J.

Znj. M debaton me njërën nga të ftuarat, lidhur me temën: “Burra me fustane”

D. M: “Ata prekin të ardhmen e fëmijëve tanë. Ty të duket e drejtë ajo veshje për fëmijët?”

E ftuara, S. J: “Po s’është fëmijë ai, është 40 vjec”

D. M: “Jo jo, këtu kam një fëmijë 10 vjeç (hamendëson) që më pyet çfarë është ai burrë apo grua? Si do t’i përgjigjesh ti? No gender?”

S. J: “Nuk më intereson, s’është fëmija aty!”

S. J, drejtuar znj. M: “Unë nuk e paragjykoj atë, ti je paragjykuese...ti fole për të drejtën publike, por ti se di çfarë është e drejta publike. Unë jam këtu dhe kam të drejtën time...”

7. NTV Televizion - Alarm - Platforma You Tube

Link: https://www.youtube.com/shorts/_BhBIRuoa5M

Materiali i vënë në dispozicion në linkun përkatës, në emisionin Top Talk, nga pala ankuese është 12 sekonda që përfshin deklaratimet e mëposhtme të znj. D. M.

D. M: “A e di çfarë thotë ligji për sterilizimin, si është shkruara aty? A e di çfarë shkruan aty? Një djalë 20 vjeçar mund të sterilizohet me një komision, por nuk vihej mosha dysHEME a sterilizohet 11 vjeç, a sterilizohet 12 vjeç...dhe çfarë dëshire ka ai....

Nuk lejohet që një djalë 13-vjeçar të pjë alkool, por mund të lejohet të zgjedhë gjininë e tij? Çfarë janë këto pislleqe?

8. Kosova Today - Platforma You Tube

Link: https://www.youtube.com/shorts/ZUVZ1hDY0_s

Është lidhje me skype, mes znj. D. M dhe gazetares nga Kosova. Minutazhi i referuar i bisedës është 51 sekonda. D. M i referohet intervistës së një stilisti me famë botërore, themelues i shtëpisë së modës Dolce & Gabbana, duke perifrastuar thëniet e tij si më poshtë:

Sikurse tha ai, që familja nuk preket, unë kam zgjedhur këtë jetë (gay)...sepse është një jetë personale ... Nëse ne, do arrijmë që brenda një komuniteti, brenda një shoqërie ku kemi dhe komunitete të ndryshme dhe bëjmë bashkimin e një jetë sociale dhe ndërthuremi së bashku, ne duhet të dimë të respektojmë kufijtë....dhe nëse kjo, LGBT, do dinte të respektonte kufijtë personal dhe të mos bëhej pjesë e kësaj agjende politike, të politikave liberale, ne do ishim shumë të lumtur, siç kemi qenë dhe më përpara.

Por, agjendat liberale janë shumë të rrezikshme për qenien njerëzore dhe për njeriun e ri. Dhe te njeriu i ri do sjelli edhe prekje në trup dhe në shëndet.

9. Tru Podcast nga Sh. G - Platforma You Tube - Data: 5 Janar 2025

Link: <https://www.youtube.com/watch?v=Lq3dMB8ULRA&t=1s>

Pasazhet e kontestuara nga Aleanca, lidhur me deklaratimet e znj. D. M, gjatë minutazhit si më poshtë citohet:

Minuta 3:45- Duhet të dallojmë një çështje personale nga një axhendë që vjen për të marrë brezin e ri, për të transformuar brezin e ri dhe për ta degjeneruar qenien njerëzore deri në një axhendë totalitare liberale që nuk është më liberalizim apo e drejta jote, por është marrja e jetës private.

Minuta 4:40-5:50: Ka djem gej që kanë kthyer, janë martuar, kanë bërë fëmijë, janë kthyer te familja. Ai ka marrë kohën e jetës së tij....sepse çdo njeri gabon, çdo njeri mendon se po bën diçka të mirë, çdo njeri mendon se po ndjek hormone, po ndjek ndjeshmërinë, po ndjek dobësinë, dhe është jeta e tij në fund të fundit. Po kush je ti që më hyn mua me forcë për të më ndryshuar Kodin Familjar? Kush je ti që më intimidon mua atë njeri që beson në Zot dhe mendon që familja është gjëja më e mirë? Kush je ti që ma thërrmon mua themelin e institucionit familjar?

Minuta 8:26: Po flasim për indoktrinim me shumë vegla. Këto janë veglat e axhendës për të indoktrinu brezin. Axhenda ka nevojë të rrisë numrin e “woke-ut” dhe të fusë sa më shumë njerëz në ushtrinë Woke. Ndaj thuhet edhe “paguhet kush deklarohet”. Paguhet kush deklarohet.

Minuta 9:30: Pse djemtë gej duhet të mbajnë tregun e surrogacisë mbi kurriz?

Minuta 10:16: Këta kanë dhe një shprehje “Molla nuk qe një rastësi”. Ne na është thenë që në fakt molla ishte një mëkat, por këta thonë që në fakt mëkati është kënaqësia jonë, liria jonë, e drejta e individit që të eksplorojë veten dhe pas tyre kush do vijë? Do vijë një botë nul.

Minuta 10:50: E zemë se Do është gabim. Nëse unë jam gabim atëhere le të lejojmë çetat të shkojnë nëpër shkolla dhe të indoktrinojnë lirinë e fëmijës që “nëse prindi ty të dhunon ti duhet ta denoncosh”, “ti nëse je djalë dhe ndjehesh vajzë...këto çmenduritë që unë nuk i konceptoj dot, por i marrim të mirëqëna...” dhe çfarë fillon pas kësaj? Kemi programin pilot në Kanada. U injektohen hormone “puberty blockers” fëmijëve.

Minuta 12:18: Këto hormone kur injektohen mbi 3 vite shkatërrojnë shëndetin e trurit. Pra po krijohet.....do krijohet një botë me të çmendur.

Minuta 30:09: Unë nuk jam vetëm. Ne nuk do lejojmë që Shqipëria t'i dorëzojë fëmijët në këtë eksperiment psikopatik. Fëmijët tanë do jenë të shëndetshëm, do trashëgojnë. Nëse kemi një pakicë me disbalancë hormonale...ata do kenë të drejtën e tyre, nuk do ngacmohen, por fëmijët tanë do jenë normal, do trashëgojnë traditën shqiptare dhe do kenë mbrojtjen tonë.

Minuta 43:50: Moderator: Kjo është lufta kundër mashkullit.

D. M: Kundër burrërisë, e kam thënë dhe unë dhe është shumë e shtrenjtë për ne gratë që të ruajmë këtë burrëri.

- **Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, si dhe në parashtrimet e depozituara nga palët, Komisioneri, ka analizuar kontentin e deklaratave, shprehjeve dhe qëndrimit të saj, në këto 9 pasazhe, dalje e pjesmarrje të saj në intervista apo emisione të ndryshme, sipër përmendur.**

Qëndrimi dhe deklaratat në fjalë, të cilat janë objekt shqyrtimi në këtë çështje, janë bërë publike nëpërmjet publikimit online, në media, televizione, you tube apo platforma të tjera, për rrjedhojë ato konsiderohen të njohura publikisht dhe Komisioneri ka administruar për efekt të hetimit administrativ linqet e secilës dalje të znj. M, ku deklarime të kësaj të fundit, janë kontestuar nga pala ankuese.

Nga këqyrja e analizimi i gjuhës së përdorur në këto dalje publike të znj. D. M, lidhur me pjesët e pretenduara nga pala ankuese, Komisioneri saktëson se, ka analizuar gjuhën e përdorur, qëndrimin dhe deklaratat e saj në këto panele pjesëmarrëse, si e ftuar, referuar transkripteve më lart, të cilat i ka vlerësuar *nëse potencialisht kishte premisa për një gjuhë që shkon në tejkalim të lirisë së shprehjes*.

Në këtë kuadër, pala ankuese pretendon se në deklaratat e znj. M, në këto dalje, është përdorur një gjuhë fyese, denigruese, gjuhë të cilën e konsideron diskriminim në formën e “*gjuhës së urrejtjes*” për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Komisioneri evidenton faktin se, gjatë procedurës së shqyrtimit të kësaj çështjeje, në zbatim të parimit të paanësisë, transparencës, kontradiktoritetit, barazisë së armëve për një proces të rregullt ligjor, ofroi mundësinë që subjekti kundër të cilit ishte paraqitur ankesa, të paraqiste para KMD-së, prapësimet dhe argumentet e saj lidhur me sa është pretenduar nga pala ankuese, në mënyrë që të mund të kundërshtonte apo sqaronte qëndrimin e saj lidhur me sa kishte deklaruar në këto emisione.

Në rastin konkret, institucioni i Komisionerit ka zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara jo vetëm në ligjin e tij rregullator, por dhe detyrimet e parashikuara në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe konkretisht nenit 78, sipas të cilit lejohen të riprodhohen pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative.

- Analiza e Komisionerit lidhur me qëndrimin, kontekstin, gjuhën dhe deklaratat e përdorura nga znj. D. M.

Paraprakisht avokati i znj. D. M, ka pretenduar në seancë se, faktet e paraqitura nga pala ankuese, nuk duhet të merren si prova, pasi mungojnë transkriptet e plota të paragrafëve dhe konteksti i thënieve të shkëputura është i deformuar, pra duhej transkriptuar paragrafi i tërë, i plotë, pasi thëniet e cituara nxirren jashtë kontekstit.

Gjithashtu, sipas av. G (përfaqësues ligjor i znj. M) faktet e paraqitura nuk duhen marrë si prova, pasi nuk janë marrë në formën e kërkuar nga ligji, tek Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA).

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

- Ky pretendim rezulton i pabazuar, pasi vetë znj. D. M dhe avokati i saj në parashtrimet me shkrim, pas njohjes dhe dijenisë për ankesën e Aleancës, e kanë kundërshtuar atë në përmbajtjen e saj, duke u shprehur se, deklarinimet e znj. D. M në emisionet televizive, podcastet e paraqitura, nuk përmbajnë gjuhë fyese, denigruese dhe urrejtjeje ndaj komunitetit LGBT. Pra, nuk mohohet prezenca e D. M në këto emisione, por kundërshtohet fakti se, deklarinimet e saj nxisin gjuhë urrejtjeje.
- Linqet e emisioneve televizive dhe podcasteve ku ajo ka marrë pjesë, janë vënë në dijeni dhe në dispozicion të personit D. M, ato janë të aksesueshme aktualisht edhe në platformën You tube.
- Pretendimi se këto emisione duhet t'i ishin kërkuar AMA-s mbetet i pa argumentuar ligjërisht, përderisa as në parashtrimet me shkrim, as në seancë dëgjimore nuk u pretendua se këto emisione janë deformuar, fallsifikuar, fshirë, mbivendosur, apo forma të tjera të fallsifikimit televiziv e digjital, përkundrazi, nga tërësia e parashtrimeve të znj. D dhe avokatit të saj, ndër të tjera, ka sjellë pasazhe, paragrafe të tërë të transkriptuar për çdo emision, si për të dhënë kontekstin e deklarinimeve të saj në çdo emision, ashtu dhe për të hedhur poshtë sipas saj, ankesën e Qendrës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”.
- Nëse do të kishte të dhëna e indicie për deformim të materialit televiziv apo podcaste në You tube, sigurisht që Komisioneri, nuk do të shqyrtonte në themel këto prova, por, do të orientonte palën pretenduese për t'iu drejtuar me kallëzim penal prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm, për veprën penale të fallsifikimit, veprim të cilin, shtetasja D. M ka qenë e lirë ta bënte, që nga momenti që është vënë në dijeni të ankesës.
- Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, faktet e paraqitura nga Qendra “Aleanca”, filmimet, etj, përbëjnë prova ligjore, e se nuk jemi në rastet e pavlefshmërisë kur nuk lejohet përdorimi i tyre në procesin administrativ, në rastin konkret.
- **Lidhur me shqyrtimin në themel të ankesës së “Aleancës kundër Diskriminimit LGBT”, si dhe pretendimeve e prapësimeve të znj. D. M, Komisioneri e sheh të rëndësishme të nënvizojë se:**

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese, e parashikuar nga neni 22, ku sanksionohet: *“Liria e shprehjes është e garantuar.”*

Liria e shprehjes garantohet edhe në kuadër të akteve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë.

Liria e shprehjes buron nga parashikimet përkatëse në aktet juridike ndërkombëtare dhe standardet minimale të saj rezultojnë të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Shtetet palë e kanë për detyrë t'i inkorporojnë të

drejtat dhe liritë në legjislacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike për të rivendosur të drejtat e shkeluara.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme.

Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide, pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike. Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinioneve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin, shprehjen/dhënien dhe marrjen e komunikimeve në çfarëdo lloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e shprehjes është subjekt i kufizimeve, sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2.

Neni 17, i KEDNJ-së, ndalon shpërdorimin e të drejtave, duke sanksionuar: *“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë”*.

Një ndalim të ngjashëm e gjejmë të formuluar edhe në nenin 5, të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, ku sanksionohet: *“1. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejtë për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt.”*

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij.

Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

KEDNJ është forma më e rëndësishme e shprehjes së angazhimit të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për vlerat e demokracisë, paqes dhe drejtësisë dhe nëpërmjet tyre, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve që jetojnë në këto shoqëri. Kjo Konventë përmban parashikime të rëndësishme mbi lirinë e shprehjes, ku përveç mbrojtjes që i siguron kësaj të drejte, përcakton edhe kufizimet përkatëse.

Për sa më sipër, në Nenin 10, të KEDNJ-së parashikohet shprehimisht:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë liçencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Në paragrafin e parë të këtij neni përkufizohen të drejtat e mbrojtura, ndërkohë që në paragrafin e dytë të tij, përcaktohen rrethanat në të cilat një shtet në mënyrë të legjitimuar mund të ndërhyjë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes. Për më tepër, neni 10 i KEDNJ-së, mbron jo vetëm përmbajtjen e informacionit dhe ideve, por edhe formën në të cilën janë shprehur ato. Kështu, dokumentet e shkruara, transmetimet në radio dhe televizione, pikturat, filmat, apo edhe sistemet e informacionit elektronik janë gjithashtu të mbrojtura sipas këtij neni. Për pasojë, mjetet e prodhimit dhe komunikimit, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit dhe ideve mbulohen gjithashtu nga neni 10, i KEDNJ dhe institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe gjykatat duhet të jenë të ndërgjegjshëm për zhvillimet e shpejta teknologjike dhe mënyrës së si liria e shprehjes mund të ndahet nëpërmjet mënyrave të tilla.

Mbështetur në paragrafin 2, të nenit 10 të KEDNJ-së, autoritetet vendase në çdonjërin nga Shtetet Kontraktues mund të ndërhyjnë me ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen 3 (tre) kushte së bashku⁴⁴:

1. Ndërhyrja (në kuptimin e “formalitetit”, “kushtit” ose “sanksionit”) parashikohet me ligj;
2. Ndërhyrja ka si qëllim të mbrojtë një ose më shumë nga interesat ose vlerat e mëposhtme: sigurimin kombëtar; integritetin territorial; sigurinë publike; ndalimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit; mbrojtjen e shëndetit; moralit; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve; ndalimin e zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë, dhe garantimin e autoritetit të paanshmërisë së gjyqësorit;
3. Ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nevoja për të mbrojtur “të drejtat e të tjerëve” është një moment i rëndësishëm kufizues për të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Engels and Others*, GJEDNJ është shprehur se: “nuk ka arsye që të mohosh lirinë e shprehjes, por vetëm të dënosh ushtrimin abuziv të asaj lirie.....”⁴⁵.

Më tej, Gjykata ka garantuar lirinë e medias duke u shprehur në mënyrë të përsëritur se: “...kërkesa e përgjithshme që gazetarët të distancohen sistematikisht dhe formalisht nga përmbajtja e një citimi që mund të çojë në fytyrje apo provokim të të tjerëve, apo të dëmtojë reputacionin e tyre nuk pajtohet me rolin e shtypit për të ofruar informacion mbi çështjet e ditës, opinionet dhe idetë.”⁴⁶

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet shprehimisht: “Liria e shprehjes është e garantuar.” Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike.

Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinionëve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin shprehjen/dhënie dhe marrjen e komunikimeve në çfarëdolloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e shprehjes është objekt i kufizimeve sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara

⁴⁴ Carss-Frisk, M., Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane - Liria e Shprehjes;

⁴⁵ Engels and Others kundër Hollandës, 1976.

⁴⁶ Thoma kundër Luksemburgut/64; Albert-Engelmann-Gesellschaft mbH kundër Austrisë.

në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2 si dhe nenit 17 të saj.

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij të marra së bashku me nenin 20/2.

Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), kufizimet e vendosura nga neni 10/2 i KEDNJ, zbatohen jo vetëm për 'informacionet' ose 'idetë' që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jofyese ose si çështje indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e atij pluralizmi, tolerance dhe mendjegjerësie pa të cilat nuk ka 'shoqëri demokratike'. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se çdo 'formalitet', 'kusht', 'kufizim' ose 'dënim' i vendosur në këtë sferë duhet të jetë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur". (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 7 dhjetor 1976, paragrafi 49*).

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke përfshirë edhe gjininë, ndalon çdo formë të shprehjes në publik, me çdo mjet, të promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes për këto shkaqe. Këto shprehje, përbëjnë "gjuhë urrejtje", e cila sipas ligjit përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit.

Kufizimi i gjuhës së urrejtjes duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve a grupeve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike.

Në bazë të nenit 10 të KEDNJ-së, e aplikueshme brenda territorit dhe juridiksionit shqiptar, referuar shkurtimisht jurisprudencës së GJEDNJ-së në çështjet Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Ebakan kundër Turqisë, vlerat e demokracisë si toleranca dhe respekti ndaj dinjitetit të barabartë të çdo qenieje njerëzore kërkojnë kufizimin e lirisë së shprehjes sa herë është e nevojshme në një shoqëri demokratike, e sidomos për të ndaluar apo parandaluar të gjitha format e shprehjes

që shpërndajnë, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtje bazuar në mungesën e tolerancës dhe që shkaktojnë ofendime apo shqetësim ndaj grupimeve të caktuara të shoqërisë⁴⁷.

Liria e shprehjes garantohet edhe në kuadër të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Në nenin 19, të Paktit, sanksionohet se: *“1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje. 2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij. 3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.”*

Barazia dhe mosdiskriminimi, janë gur themeli i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 18, të saj, Kushtetuta sanksionon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Barazia dhe mosdiskriminimi janë gur themeli edhe e të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore (në vijim KEDNJ), e cila në nenin 14, ndalon diskriminimin dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke sanksionuar: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”,* si dhe Protokollin Nr. 12 të KEDNJ-së, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm. Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, KEDNJ, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

⁴⁷ https://www.echr.coe.int/documents/fs_hate_speech_eng.pdf

Vendi ynë ka ratifikuar shumë prej traktateve për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, ndër të tjera, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili në nenin 2, pika 1, përcakton: *“1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo shkak tjetër.”*, ndërsa në nenin 26, ky Pakt sanksionon: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinion tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shkak tjetër.”*

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Sipas Rekomandimit nr. R (97) 20 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për *“Gjuhën e urrejtjes”*⁴⁸, termi *“gjuhë urrejtjeje”* do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësi kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.”

Rekomandimi Nr.15 i Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) *“Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”*, miratuar më 8 Dhjetor 2015⁴⁹, e përkufizon *“gjuhën e urrejtjes”*: *“gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e racës, ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit”*.

Po sipas Rekomandimit Nr.15, të ECRI-t, vlerësimi nëse ekziston rreziku që aktet e mësipërme të ndodhin, duhet të merret duke pasur parasysh rrethanat specifike në të cilat përdoret *“gjuha e urrejtjes”*.

Në mënyrë të veçantë duhet të mbahet parasysh:

⁴⁸ Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave.

⁴⁹ Në vijim referohet me akronimin Rekomandimi Nr.15, i ECRI-t.

- a) konteksti në të cilin po përdoret gjuha e urrejtjes në fjalë (konkretisht, nëse ekzistojnë tashmë tensione të rënda brenda shoqërisë ku përcillet kjo gjuhë e urrejtjes);
- b) aftësinë e personit që përdor gjuhën e urrejtjes për të ushtruar ndikim mbi të tjerët (p.sh. duke qenë udhëheqës politik, fetar ose komunitar);
- c) natyrën dhe forcën e gjuhës së përdorur (p.sh. nëse është provokuese dhe e drejtpërdrejtë, përfshin përdorimin e keqinformimit, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin, ose është në gjendje të nxitë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi);
- d) kontekstin e komenteve specifike (nëse janë një dukuri e izoluar ose janë ritheksuar disa herë dhe nëse ato mund të vlerësohen si të kundërbalancuara nga të tjerët ose nga vetë folësi apo dikush tjetër, sidomos gjatë një debati);
- e) mediumin (formatin) e përdorur (nëse mundëson përgjigje të menjëhershme nga publiku, për shembull një aktivitet që ndodh "direkt");
- dhe
- f) natyrën e publikut (nëse ka në dispozicion mjetet dhe prirjen apo ndjeshmërinë për t'u përfshirë në akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi)⁵⁰.

Në dy vendime, *Behar dhe Gutman kundër Bullgarisë* (nr. 29335/13, datë 16.02.2021) dhe *Budinova dhe Chaprazov kundër Bullgarisë* (nr. 12567/13, datë 16.02.2021), GJEDNJ, ka vendosur disa faktorë me rëndësi, (që nuk janë shterues) të cilët duhet të merren në konsideratë kur vlerësohet, nëse deklaratat publike negative në lidhje me një grup shoqëror ngrihen mbi “*nivelin e ashpërsisë*” për t’u konsideruar diskriminuese. Faktorët me rëndësi, që sipas GJEDNJ duhet të merren në konsideratë janë:

1. Karakteristikat e grupit (për shembull madhësia e tij, shkalla e homogjenitetit, cenueshmëria e tij e veçantë ose historia e stigmatizimit dhe pozicioni i tij përballë shoqërisë në tërësi);
2. Përmbajtjen e saktë të deklaratave negative në lidhje me grupin (në veçanti, shkallën në të cilën ato mund të përcjellin një stereotip negativ për grupin në tërësi, dhe përmbajtjen specifike të atij stereotipi);
3. Formën dhe kontekstin në të cilin janë bërë deklaratat, shtrirjen e tyre (që mund të varet nga vendi dhe si janë bërë), pozicioni dhe statusi i autorit të tyre dhe shkalla në të cilën ato mund të konsiderohen se kanë ndikuar një aspekt thelbësor të identitetit dhe dinjitetit të grupit.

Sipas GJEDNJ-së, është ndërveprimi i të gjithë këtyre faktorëve që ka rëndësi. Pra, faktorët e sipërcituar duhen konsideruar në mënyrë kumulative që të mund të vlerësohet niveli i ashpërsisë.

Kufizimi i “gjuhës së urrejtjes” duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës, për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike. Në këtë kontekst, çështja thelbësore që shtrohet në çështjen objekt shqyrtimi, është pesha respektive

⁵⁰ Rekomandimi Nr.15, i ECRI-t, Relacioni Shpjegues, Pjesa B “*Përkufizime*”, nën-ndarja “*Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes*”, pika 16.

që ka liria e shprehjes, në raport me të drejtën për të jetuar të lirë nga diskriminimi dhe për të gëzuar respekt të barabartë, të të gjithë personave pa dallim.

Në çështjen nr.618/18, Sokolovski kundër Rusisë, GJEDNJ (në vendimin e saj të datës 4 qershor 2024) trajtoi çështjen e gjuhës së urrejtjes si një vepër penale që ndërhyr në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informacionit sipas nenit 10, të KEDNJ-së⁵¹.

GJEDNJ vlerësoi se, sanksionet e vendosura ndaj një blogeri për ofendim të ndjenjave dhe nxitje të urrejtjes ndaj një grupi shoqëror në një seri video-mesazhesh kishin shkelur të drejtën e blogerit për lirinë e shprehjes. GJEDNJ vendosi njëzëri se ndjekja penale dhe dënimi i blogerit përbënte një ndërhyrje joproporcionale që nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, pasi ndërhyrjet në të drejtën e blogerit nuk gjenin justifikimin e duhur, nga autoritetet gjyqësore vendase.

GJEDNJ-ja fillimisht konfirmoi se klauzola e abuzimit e nenit 17⁵², të KEDNJ-së, mund të zbatohet vetëm në një bazë të jashtëzakonshme dhe në raste ekstreme. Kjo do të thotë se neni 17 mund të zbatohet vetëm kur është dukshëm e qartë se deklaratat e kontestuar synonin të shmangnin të drejtën e lirisë së shprehjes nga qëllimi i saj real dhe ishin dukshëm në kundërshtim me vlerat e KEDNJ. GJEDNJ konstatoi se komentet e Sokolovski, megjithëse ato mund të konsideroheshin nga një pjesë e publikut si të papërpunuara, nuk arritën një shkallë virulence për të justifikuar zbatimin e nenit 17 të KEDNJ (shih gjithashtu Perinçek kundër Zvicrës).

.....

Së fundmi, GJEDNJ-ja vlerësoi se, nuk kishte indikacione se videot përmbanin ndonjë thirrje për akte të paligjshme ose të dhunshme... dhe gjithashtu vuri në dukje se, gjykatat vendase nuk shqyrtuan nëse deklaratat e Sokolovski ishin të një natyre fyese të paqellimte për besimet fetare, ose nëse ato nxisnin mungesë respekti ose urrejtje ndaj Kishës Ortodokse. GJEDNJ arriti në përfundimin se gjykatat vendase nuk zbatuan standarde në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 10⁵³ të KEDNJ-së dhe për këtë arsye nuk dhanë arsye “përkatëse dhe të mjaftueshme” për të justifikuar ndërhyrjen në fjalë, prandaj vlerësoi se ka pasur shkelje të nenit 10 të KEDNJ.

Sipas GJEDNJ-së, sulmi kundër reputacionit të personit/personave duhet të arrijë një nivel të tillë të rëndë, në mënyrë që të shkaktojë paragjykim të gëzimit të së drejtës së respektimit të së drejtës nga individ/individët. Gjuha e urrejtjes konsiderohet e tillë edhe kur efekti që prodhon apo krijon pritshmërinë se mund të nxisë drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit armiqësisë apo diskriminimit.

Në Rekomandimin CM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Europës për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132), përcaktohet se: *“Në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin e llojit të përgjegjësisë, nëse ka, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike,*

⁵¹ Shih gjithashtu Lenis kundër Greqisë dhe Tagiyev dhe Huseynov kundër Azerbajxhanit.

⁵² Neni 17, “Nalimi i shpërdorimit të të drejtave”, përcakton se: *“Asnjë dispozitë e Konventës nuk mund të cënojë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në të”*.

⁵³ Neni 10, “Liria e shprehjes”: *“Çdokush ka të drejtën të shprehë dhe të shkruajë atë që mendon, si dhe të japë e marrë informacione. Kjo e drejtë përfshin edhe lirinë e shtypit.”*

autoritetet e shteteve anëtare dhe palët e tjera të interesuara, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës, duhet të marrin parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimin ndërmjet tyre: përmbajtja e shprehjes; konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; qëllimi i folësit; roli dhe statusi i folësit në shoqëri; si shpërndahet apo përforcohet shprehja; aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.

Për të vlerësuar nëse ekziston rreziku që aktet e promovuara ose të nxitura nga gjuha e urrejtjes të ndodhin, Komisioneri ka marrë në konsideratë rrethanat e mëposhtme, në përputhje me frymën e Rekomandimit të ECRI-t.

Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi shprehjet e qëndrimi janë realizuar nëpërmjet fjalëve të deklaruara dhe në mënyrë publike, pasi deklaramet e bisedat janë bërë në platforma televizive, platforma mediatike online, apo të tjera, të cilat përfshihen në mjetet e përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

Në këtë kontekst, lidhur me pretendimin e subjekti ankues për përdorim të gjuhës së urrejtjes nga ana e znj. D. M, në daljet e saj publike, mediatike, të sipërcituara, Komisioneri ka analizuar materialet gjatë shtjellimit të mëposhtëm.

- **Në lidhje me deklaramet e znj. M në 6 episodet e tjera, në emisionet: “Bardh a Zi, datë 22 Maj 2024”, “Podcard – ShpresON, datë 16 Maj 2024”, “Podcard – ShpresON, datë 18 Maj 2024”, “Shqipëria Live, datë 24 Dhjetor 2024”, “E Diell, datë 12 Janar 2025” dhe “Tru Podcast nga Sh. G, datë 5 Janar 2025”.**

Në lidhje me këto 6 (gjashtë) episode, pjesëmarrje në televizione e podcaste, të cilat janë pasqyruar sa më sipër në vendim, Komisioneri vlerëson se, deklaramet e saj, kanë kapërcyer të drejtën për liri të shprehjes, pasi kanë nxitur, promovuar ofendime dhe shqetësime ndaj komunitetit LGBT në përgjithësi, dhe “Aleancës kundër Diskriminimit LGBT” në veçanti.

Ndër të tjera, respektivisht, evidentohen shprehjet e znj. D. M, në këto emisione:

- **“Bardh a Zi”, datë 22 Maj 2024.**

Koha e emisionit e vënë në vënë në dispozicion është 1 orë, 35 minuta e 11 sekonda. Emisioni ka 6412 shikime.

Pjesëmarrës në diskutim janë: znj. D. M, prezantuar si aktiviste e “Aleancës Pro Familjes”, z. E. T, gazetar, znj. S. C, juriste dhe anëtare e Partisë së Lirisë dhe znj. E. H, gazetare, studiuese sociale.

Moderues dhe bashkëbisedues me të ftuarit janë z. E. K dhe znj. O. G.

Tematika e diskutuar ka marrë shkas nga “martesa” e dy vajzave E. M dhe A. A, persona të së njëjtës gjini, të zhvilluar në terracën e godinës së Bashkisë Tiranë, në datën 19 Maj 2024, ora 18:00,

dhe impakti dhe këndvështrimi i të ftuarve lidhur me çështjet që lidhen me familjen, fëmijët dhe identifikimin atëror e mëmësor në të tilla situata.

Në këtë emision evidentohen ndër të tjera, këto deklaramë të znj. M:

“A ka fëmijë gay? Fëmijët nuk janë gay. Se jemi ne të rritur, kemi kaluar një fëmijëri dhe nuk kuptonim çfarë ishte, por ishim në një marrëdhënie shumë të pastër. Dhe njeriut, qënies njërëzore, i shkon të ketë edhe një jetë private, të pa prekur dhe të pacenuar nga një grup që troket, si ai ujku te kecat dhe thotë: ‘Më falni, a doni leksione për gejllëk dhe gjenderizim? Po ju, a doni sorrogaci? Ne kemi çdo datë një, në maj, çdo vit, vihet dhe thuhet: A keni djem për ti bërë gay? A keni keni surrogaci? – na thanë këtë vit.

....Kam kaq kohë që po kërkoj kromozomin “no gender” në biologji. A kam lënë bibliotekë pa bredhur? Po ma nxirrni more atë kromozon, si e ka fytyrën që ta shikoj kromozonin “no gender”, sepse njohim vetëm xx, xy. Dhe si ndihesh ti, nuk më bëhet vonë fare, se ti, mund të ndihesh edhe si një person që do të bësh “pipinë” në rrugë.

.....Ti që e kërkon atë jetë, ti që vishesh si trans, ti e ke menduar që dikush do ta thotë një fjalë, po mbaje mbi kurriz, se atë po kërkon.

.....Unë nuk kam kërkuar kurrë ligjin që e gjithë botëa, sic po e shohim në Perëndim, të bëhet gay ose lesbike.

.....Po sjellin frymën e gjenderizimit te fëmijët. Sepse ku është futur? Ne e shikojmë që në të njëjtin muaj është tundur Shqipëria, sepse na ka ardhur dhe ligji, ku këto ndryshime ishin bërë me kërkesë të organizatës, Aleancës LGBT. Këta kishin sjellë kërkesën për ndryshimin e rregullimit të shëndetit seksual të fëmijëve, të të rinjve, të moshës së re.

....Ata nuk mund të vendosin dot për shumicën dhe të prekin edhe komunitetet fetare, edhe respektin e nënës! Ata po degenerojnë nënën me surrogacinë!

....E di çfarë janë këto bebe që këta ia heqin gjirit të nënës dhe ia çojnë dy burrave trans? A dinë këta çfarë po prekin?! Ky është buton i kuq i Krijuesit. Nuk mund ta prekësh butonin e kuq të Krijuesit, sepse do sillnim fundin. Ky është fundi”.

- **“Podcard – ShpresON”, datë 16 Maj 2024.**

Koha e emisionit është 1 orë, 19 minuta e 9 sekonda. Emisioni ka 2004 shikime.

Në titrat e emisionit shkruhet:

“Kundër projekligjeve të surrogacisë, sterilizimit të të rinjve dhe martesave gay.”

D. M: “Propaganda LGBQ tek fëmijët është Agjendë Satanike”.

Emisioni zhvillohet në trajtën e bashkëbisedimit mes znj. D. M dhe av. A. G.

“Nuk e kuptoj si mund ta quajnë homofob një person që thjesht shpreh mendimin etij se këta njerëz nuk duhet të futen në shkollë, sepse fëmijët duhet të ruajnë pastërtinë dhe singleritetin e tyre.

... “Dhe pjesa që paska nisur, unë nuk e dija atë, paska nisur që shkojnë në shkolla, po normal nuk janë si ato foto që kisha postuar unë me drag queen, me figurën e djallit. Pra, një drag queen shkon e veshur si djall te fëmijët”.

Prindërit janë lebetitur dhe unë kam një video në rrjetet sociale ku tregohen prindër që kanë marrë fëmijët e tyre nga Kanadaja dhe janë larguar për në Rusi.”

- **“Podcard – ShpresON”, datë 18 Maj 2024.**

Koha e emisionit, e vënë në dispozicion nga pala ankuese është 1 orë, 38 minuta e 5 sekonda. Emisioni ka 2404 shikime.

Bashkëbisedues në këtë emision janë : av. A. G, znj. D. M dhe z. V. K.

Në titrat e emisionit shkruhet: “Verifikimi i fakteve dhe provave se si Erjoni (Kryetari i Bashkisë Tiranë) dhe Ajola (bashkëshortja e tij) organizuan ritet e ndyra satanike dhe aktet e turpshme për fëmijët për të shpëtuar nga SPAK”.

Është diskutuar në lidhje me shfaqjen e dhënë nga Cirku Francez në Liqenin Artificial të Tiranës, me datë 15 Maj 2025, në kuadër të javës kulturore të franceze, nga Trupa e Teatrit Bashkëkohor Francëz, shfaqje e mbështetur nga Bashkia e Tiranës, Ambasada Franceze dhe disa ambasada të tjera me seli në Tiranë, sipas bashkëbiseduesve në emision.

Kjo shfaqje sipas tyre, paraqet rituale satanike dhe që dëmtojnë të miturit. Është diskutuar ndër të tjera, “martesa” që do bëhej mes dy vajzave, (ku njëra ishte me fëmijë) dhe që sipas diskutuesve, të dyja këto momente të mbështetura nga Kryebashkiaku E. V, janë përpjekje të tij për të shpëtuar dhe larguar vëmendjen e opinionit publik nga hetimet e SPAK-ut kundrejt tij.

Është diskutuar gjithashtu, për nismat ligjore të ndërmarra për shëndetin seksual dhe atë riprodhues, të cilat sipas bashkëbiseduesve, janë pjesë e “Agjendës”.

Emisioni është zhvilluar pas një shfaqjeje të Cirkut Francez në Liqenin Artificial të Tiranës, me datë 15 Maj 2024, i cili duhet thënë se shkaktoi një debat të madh publik. Në këtë emision janë diskutuar aspekte të ndryshme të kësaj shfaqjeje si: elementë të caktuar të performancës (konkretisht performancën e një pjesëtari të trupës artistike, që me veshjen e maskimin e tij, paraqet brirët, gjinjtë femëror, si dhe formën e organit gjenital mashkullor) mbështetja e Bashkisë Tiranë për këtë shfaqje, thirrja e ftesa për ta ndjekur atë nga prindërit me fëmijë, etj.

Pra, problematika këto që në vetvete, me të drejtë janë parashtruar në këtë emision, pasi, shprehin një shqetësim publik, për detaje të caktuara të kësaj shfaqjeje të këtij Cirkut, e që, mbase duhej të ishte zhvilluar në një ambient të mbyllur dhe të kufizuar për moshat mbi 18 vjeç, apo dhe me fletë palosje paraprake informuese e sqaruese për përmbajtjen e elementët e tjera të Cirkut Francez, etj. Sigurisht në këtë podcast janë diskutuar edhe tematika të tjera që tejkalojnë dhe nuk i shërbejnë objektit të ankesës në shqyrtim.

Nga ana tjetër, në këtë podcard, evidentohen këto pohime nga ana e znj. M:

“.....Unë kam kohë që po paralajmëroj që po, po ... po vjen, po afron fryma e perëndimit. Që i kanë marrë fëmijët nga shkolla, i kanë injektuar hormone, ia kanë kthyer në trans.

....E di kush janë homofob për ta? Jemi ne që i ndalojmë, të kalojnë të kontrollojnë fëmijët tanë, për të kaluar në kampet naziste të axhendës dhe planit të tyre për botën Sodom e Gomorra.

.... “E di kush janë “homofobët” për ta? Jemi ne, ata që i ndalojmë të vijnë dhe të kontrollojnë fëmijët tanë. Të na cojnë në kampet naziste të agjendës dhe planit të tyre për një botë si Sodoma dhe Gomorra....Por kjo ka marrë fund!”

- Emisioni “Shqipëria Live”, i datës 24 Dhjetor 2024.

Koha e emisionit, vënë në dispozicion nga pala ankuese është 4 minuta e 35 sekonda. Emisioni ka 4078 shikime.

Në këtë pasazh evidentohet dabati i zhvilluar mes znj. D. M dhe z. A. H, përfaqësues i Qendrës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Fëmijë e (CRCA).

Tematika e prezantuar me titra është: *“Trump premtion – Vetëm dy gjini”*.

Nga debati evidentohet:

“...Po ku ka fëmijë trans? Ku i krijuat ju këto fëmijë trans? Nuk e ka parë historia që të ketë fëmijë trans.Nëse ekzistojnë fëmijë trans atëherë ekziston pedofilia. Pedofilia s`do lejohet kurrë nga ne. Nuk ka fëmijë trans!

....I drejtohet aktivistit LGBTI+ dhe më pas lëvizjes LGBTI+: Ti je linja e Kamalës. Ti je për psikolog...Ti je linja ku fëmijët bëhen transa. Çfarë doni jut e fëmijët e prindërve? Çfarë kërkoni nga fëmijët? Ju në Shqipëri s`do arrini dot kurrë të prekni fëmijët.”

- “E Diell”, datë 12 Janar 2025.

Koha e emisionit, vënë në dispozicion nga pala ankuese është 9 minuta e 26 sekonda. Emisioni ka 1698 shikime.

Paraqitet një bisesë e zhvilluar në këtë emision me znj. D. M, ku të pranishëm janë edhe të ftuar të tjerë, mes të cilëve dhe pastori P. V, z. E. M, dhe ish pjesëmarrës të reality showt Big Brother Vip Albania.

“...Unë kam shok gej konservatorë të cilët të qenurin gej e shikojnë si një problem të tyrin personal....në jetën publike japin vlerat publike, japin kontributin e tyre publik, profesional, mund të bëjnë dy-tre punë që të përballojnë jetesën, ama...nuk bëhen pjesë e një axhende për të transformuar dhe degjeneruar të gjithë njerëzit...

.... Konservatorë janë ata që arrijnë të bëjnë dallimin midis një të drejte personale dhe dikujt ë kërkon të nderhyjë në shoqëri me dhunë, që kërkon të japi një shtysë të drejtave të Kodit Familjar dhe për ta transformuar atë në favor të kësaj pakice. Ne nuk mundemi të shkatërrojmë një Kod Familjar për këtë pakicë....

.....Personat LGBTI+ biologjikisht janë ndryshe. Vetë e kanë pranuar që kanë një disbalancë hormonale. Ti nuk e mohon dot biologjinë. Të gjithë këta “no-gender” e mohojnë biologjinë. Të drejtën personale mbaje për vete. Pse duhet të shkosh me një axhendë për të shtyrë popullin, për të shkuar në shkollë? Kush ta jep ty të drejtën të futesh te fëmijët?”

- **“Tru Podcast nga Sh. G”, datë 5 Janar 2025.**

Koha e emisionit është 1 orë, 51 minuta e 33 sekonda. Emisioni ka 4736 shikime.

Në titrat e emisionit shkruhet: “Familja si dikur apo Prindi 1 dhe 2?”

“....Duhet të dallojmë një çështje personale nga një axhendë që vjen për të marrë brezin e ri, për të transformuar brezin e ri dhe për ta degjeneruar qenien njerëzore deri në një axhendë totalitare liberale që nuk është më liberalizim apo e drejta jote, por është marrja e jetës private.

.....Ka djem gej që kanë kthyer, janë martuar, kanë bërë fëmijë, janë kthyer te familja. Ai kamarrë kohën e jetës së tij....sepse çdo njeri gabon, çdo njeri mendon se po bën diçka të mirë, çdo njeri mendon se po ndjek hormone, po ndjek ndjeshmërinë, po ndjek dobësinë, dhe është jeta e tij në fund të fundit. Po kush je ti që më hyn mua me forcë për të më ndryshuar Kodin Familjar? Kush je ti që më intimidon mua atë njeri që beson në Zot dhe mendon që familja është gjëja më e mirë? Kush je ti që ma thërrmon mua themelin e institucionit familjar?

..... Po flasim për indoktrinim me shumë vegla. Këto janë veglat e axhendës për të indoktrinu brezin. Axhenda ka nevojë të rrisë numrin e “woke-ut” dhe të fusë sa më shumë njerëz në ushtrinë Woke. Ndaj thuhet edhe “paguhet kush deklarohet”. Paguhet kush deklarohet.

..... Pse djemtë gej duhet të mbajnë tregun e surrogacisë mbi kurriz?

.....Këta kanë dhe një shprehje “Molla nuk qe një rastësi”. Ne na është thenë që në fakt molla ishte një mëkat, por këta thonë që në fakt mëkati është kënaqësia jonë, liria jonë, e drejta e individit që të eksplorojë veten dhe pas tyre kush do vijë? Do vijë një botë nul.

.....E zemë se D është gabim. Nëse unë jam gabim atëhere le të lejojmë çetat të shkojnë nëpër shkollë dhe të indoktrinojnë lirinë e fëmijës që “nëse prindi ty të dhunon ti duhet ta denoncosh”, “ti nëse je djalë dhe ndjehesh vajzë...këto çmenduritë që unë nuk I konceptoj dot, por i marrim të mirëqëna..” ... dhe çfarë fillon pas kësaj? Kemi programin pilot në Kanada. U injektohen hormone “puberty blockers” fëmijëve.

.....Këto hormone kur injektohen mbi 3 vite shkatërrojnë shëndetin e trurit. Pra po krijohet.....do krijohet një botë me të çmendur.

.....Unë nuk jam vetëm. Ne nuk do lejojmë që Shqipëria t'i dorëzojë fëmijët në këtë eksperiment psikopatik. Fëmijët tanë do jenë të shëndetshëm, do trashëgojnë. Nëse kemi një pakicë me disbalancë hormonale...ata do kenë të drejtën e tyre, nuk do ngacmohen, por fëmijët tanë do jenë normal, do trashëgojnë traditën shqiptare dhe do kenë mbrojtjen tonë.”

Nga tërësia dhe koherenca e deklarimeve të mësipërme, të znj. D. M, në emisione të ndryshme, referuar dhe tematikës së trajtuar dhe kontekstit të tyre, rezulton se, përtej bindjeve të saj, mënyra e shprehjes, reagimit, duke ngritur “alarmin shoqëror” se një “Agjendë liberale” (e mbështetur nga SOROS, sipas znj. M), e cila, pasi ka pushtuar Perëndimin (citim i znj. M: “...nuk kam kërkuar kurrë ligjin, që e gjithë bota, siç po e shohim në Perëndim, të bëhet gay ose lesbike...”), po implementohet edhe në shoqërinë shqiptare:

Martesat mes së njëjtës gjini, surrogacia, ndryshmet seksuale të fëmijëve (citim i znj. M: “... ne e shikojmë se në të njëjtin muaj është tundur Shqipëria, sepse na ka ardhur edhe ligji ku këto ndryshime ishin bërë me kërkesë të organizatës “Aleanca LGBT”), duke nënkuptuar se janë veprime si të personave të caktuar të komunitetit LGBT, ashtu dhe drejtpërdrejtë të Qendrës, “Aleancës LGBT”; apo deklaratimet se ky është një program pilot në Kanada dhe se ne jemi vende eksperimentale, dhe se, në vijim të “Agjendës liberale”, një grup troket si ai ujku te kecat edhe thotë⁵⁴: “A doni leksione gjellëku dhe gjenderizim? Po ju, a doni surrogaci? Në çdo datë 1, në muaj vihet e thuhet: A keni djem për të bërë gay? A kemi surrogaci, na thonë këtë vit....”, gjithnjë duke nënkuptuar personat apo grupet LGBT, dhe se këto veprime synojnë shkatërrimin e familjes dhe fëmijëve. (ku sipas znj. M, në ndonjë vend tjetër u kanë injektuar hormone fëmijëve për t'i kthyer në trans), për të kaluar në kampet naziste të “Agjendës”, dhe planit të tyre për botën Sodom e Gomorra- qytete biblike këto, që për shkak të degjenerimit, mëkateve të tejskajshme, u dënuan me shkatërrim nga Zoti.

Komisioneri duke analizuar e vlerësuar, deklaratime, shprehje e citime të tilla si:

“... ”

Këto hormone kur injektohen mbi 3 vite shkatërrojnë shëndetin e trurit. Pra po krijohet.....do krijohet një botë me të çmendur.

....

Dhe njeriut, qënies njërëzore, i shkon të ketë edhe një jetë private, të pa prekur dhe të pacenuar nga një grup që troket, si ai ujku te kecat dhe thotë: ‘Më falni, a doni leksione për gjellëku dhe gjenderizim? Po ju, a doni sorrogaci? Ne kemi çdo datë një, në maj, çdo vit, vihet dhe thuhet: A keni djem për ti bërë gay?’

.....

“Ti që e kërkon atë jetë, ti që vishesh si trans, ti e ke menduar që dikush do ta thotë një fjalë, po mbaje mbi kurriz, se atë po kërkon”

...

Unë nuk kam kërkuar kurrë ligjin që e gjithë bota, sic po e shohim në Perëndim, të bëhet gay ose lesbike.

⁵⁴ Citim i znj. M.

“Këto të drejtën private po ia imponojnë publikut dhe kjo është ajo që ne kundërshtojmë. Mos impononi!

....

Po çfarë prek ajo? (kërkesa e supozuar e Aleancës LGBT) Ajo prek brezin e ri. Çfarë prek? Familjen e re, pleqërinë tonë dhe familjen e re. Ai është projekt, ai është projekt i mirëmenduar. Pse? Se i ngjan programit pilot në Kanada, është program pilot lart në perëndim dhe ne jemi vende eksperimentale”

...

...paska nisur që shkojnë në shkolla...

Që i kanë marrë fëmijët nga shkolla, i kanë injektuar hormone, ia kanë kthyer në trans”.

“E di kush janë homofob për ta? Jemi ne që i ndalojmë, të kalojnë të kontrollojnë fëmijët tanë, për të kaluar në kampet naziste të axhendës dhe planit të tyre për botën Sodom e Gomorra”.

Të na cojnë në kampet naziste të agjendës dhe planit të tyre për një botë si Sodoma dhe Gomorra....

....

Po ku ka fëmijë trans? Ku i krijuat ju këto fëmijë trans? Nuk e ka parë historia që të ketë fëmijë trans. Nëse ekzistojnë fëmijë trans atëhere ekziston pedofilia. Pedofilia s’do lejohet kurrë nga ne. Nuk ka fëmijë trans!

.....

Ne nuk mundemi të shkatërrojmë një Kod Familjar për këtë pakicë....

...;

Personat LGBTI+ biologjikisht janë ndryshe. Vetë e kanë pranuar që kanë një disbalancë hormonale. Ti nuk e mohon dot biologjinë. Të gjithë këta “no-gender” e mohojnë biologjinë. Të drejtën personale mbaje për vete. Pse duhet të shkosh me një axhendë për të shtyrë popullin, për të shkuar në shkolla? Kush ta jep ty të drejtën të futesh te fëmijët?

.....

....për ta degjeneruar qenien njerëzore

...“ti nëse je djalë dhe ndjehesh vajzë...këto çmenduritë që unë nuk I konceptoj dot, por i marrim të mirëqëna..”...;

Komisionieri gjykon se, deklarime e komente të tilla apo përdorimi i krahasimorëve negativ, kanë premisa reale e serioze për të krijuar: dizinformim, ankth, frikësim, panik, urrejtje e indinjatë, tek një pjesë e publikut, duke paraqitur kështu si autorë e përgjegjës të “agresionit” ndaj shoqërisë, personat e komunitetit LGBT.

Pra, këto pohime të znj. M, duke shigjetuar persona të caktuar, grupimin LGBT, e kanë ekspozuar këtë të fundit përballë një gjuhe agresive, fyese, me fakte të pavërteta, apo me episode të paidentifikuara, të veçanta, të cilave u jepet një vlerë absolute apo përgjithësuese - çka përmban elementët e gjuhës së urrejtjes dhe të diskriminimit të përsëritur, vazhdues e konstant.

Konkretisht, ndër të tjera, sipas pohimeve të znj. M, “Aleancës LGBT”, i atribuohet fakti se, me kërkesë të saj, “ka ardhur ligji për ndryshimin e rregullimit të shëndetit seksual të fëmijëve dhe surrogacinë...”.

Në fakt, Komisioneri, vëren se, bëhet fjalë për projektligjin “Për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues”, i hartuar nga Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) dhe i afishuar për njohje dhe konsultim publik, prej saj, nga data 18.04.2024 – 16.05.2024.

Ndryshe nga sa është pretenduar e propoganduar, Qendra “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”, pasi është njohur me projekt ligjin e mësipërm, ka paraqitur nëpërmjet shkresës me nr. 8 prot., me datë 15.05.2024, komentet dhe argumentet përkatëse (sipas këndvështrimit të tyre) për dispozita të veçanta të tij, dhe konkretisht cituar si më poshtë vijon:

“ *Komente në lidhje me projektligjin “Për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues”* ”

Pasi konsultuam përmbajtjen e parashikimeve të këtij projektligji, shohim me shqetësim këto pika:

- 1. Projektligji “Për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues” ndryshon afatin për nderprerjen shtatzënisë:*

Ligji Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”, në nenet 9, 10 dhe 11 përcakton se:

- Kur gruaja vlerëson se shtatzënia i krijon probleme psikosociale, ndërprerja e vullnetshme mund të kryhet brenda javës së 12 të shtatzënisë;*
- Për arsye mjekësore mund të bëhet deri në javën e 22 të shtatzënisë, në rast se një komision i përbërë nga 3 mjekë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se vazhdimi i shtatzënisë dhe/ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e gruas;*
- Për arsye sociale bëhet brenda javës së 22, në rast se një komision i përbërë nga 3 specialistë, mjekë, punonjës socialë, juristë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se shtatzënia është rezultat i përdhunimit ose një krimi tjetër seksual, si dhe kur vërtetohen arsye të tjera sociale;*
- Kur komisioni gjykon se fetusi ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurtë, vendos për ndërprerjen e shtatzënisë në çdo kohë.*

Ndërkohë, projektligji “Për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues”, në nenet 12 dhe 13 të tij kategorizon ndërprerjen e shtatzënisë si ndërprerje vullnetare dhe për arsye shëndetësore:

Ndërprerja vullnetare:

- Brenda 14 javëve të para të shtatzënisë me kërkesë të gruas që mbart fëmijën dhe në përmbushje të kërkesave të ligjit;*

Ndërprerja për arsye shëndetësore:

- Deri në javën e njëzet e dytë të shtatzënisë, nëse jeta ose shëndeti i gruas është në rrezik serioz;*
- Deri në javën e njëzet e dytë të shtatzënisë, kur ekziston rreziku i anomalive serioze të fetusit, të konfirmuar paraprakisht Komisioni i Posaçëm;*
- Deri në javën e njëzet e dytë të shtatzënisë, kur shtatzënia është rezultat i përdhunimit, marrdhënieve seksuale me dhunë ose një krimi tjetër seksual;*
- Kur komisioni i Posaçëm gjykon se fetusi ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurtë ose nëna ka një sëmundje e cila mund të*

rëndohet nga shtatzënia ose që kërkon një trajtim urgjent, vendos për ndërprerjen e shtatzënisë në çdo kohë.

Koment:

Nëse krahasojmë përmbajtjen e këtyre parashikimeve, rezulton se projektligji zgjat për një periudhë 2 javore afatin e ndërprerjes në mënyrë vulletare të shtatzanisë me kërkesë të gruas shtatzënë dhe në përmbushje të kërkesave të ligjit, zgjatje e cila rrit mundësinë e gruas shtatzënë për të vendosur mbi shtatzëninë dhe trupin e saj, duke përmirësuar nivelin e respektimit të autonomisë dhe integritetit trupor.

Nga ana tjetër projektligji eliminon komponentin “arsye të tjera sociale” si bazë për të justifikuar ndërprerjen e shtatzanisë deri në javën e 22-të, duke e hapur dispozitën vetëm ndaj shtatzanive që vijnë si rrjedhojë e përdhunimit apo krimeve të tjera seksuale.

Eliminimi i komponentit “arsye të tjera sociale”, i cili e hap dispozitën në ligjin pararendës ndaj realiteteve sociale të ndryshme të grave në nevojë për ndërprerje shtatzanie, në bazë të situatave të tyre specifike që vlerësoheshin rast pas rasti, është një aspekt problematik i projektligjit të propozuar, pasi ndikon në mënyrë direkte në mohimin e realiteteve sociale të komplikuar të grave, kufizon hapësirën e tyre për të kryer zgjedhje dhe për të vendosur mbi shtatzëninë dhe trupin e tyre, duke zvogëluar nivelin e autonomisë dhe integritetit trupor të këtyre grave. Mungesa e këtij parashikimi sjell probabilitetin që projektligji të mbetet i verbër dhe i ngurtë ndaj situatave specifike të të gjitha grave, duke vështirësuar jetët e tyre përballë pamundësisë të zgjedhjes, pas javës së 14 të shtatzanisë, ndërkohë që ligji në fuqi e lë të hapur këtë zgjedhje deri në javën e 22-të të shtatzënisë, për një periudhë shtesë prej 8 javësh.

Në këtë linjë sugjerojmë që parashikimi të ndjekë linjën e parashikimit të ligjit aktual, duke ruajtur komponentin e “arsye të tjera sociale”.

2.Projektligji “Për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues” nuk respekton te drejtën e gruas për autonomi trupore dhe vendimarrje:

Në nenin 5 të tij, projektligji përcakton të drejtat themelore të individëve, duke i kategorizuar ato në dy kategori kryesore: 1-Garanci për çdo individ; 2-Garanci për çdo grua.

Koment:

Shohim me shqetësim parashikimin në pikën ç: “Të drejtën të vendosin lirisht, por duke respektuar dëshirën e secilit partner, për kohën, numrin dhe intervalin e lindjeve”. Mënyra e formulimit të këtij parashikimi si dhe renditja e tij në radhë përpara garancive për çdo grua, krijon një bazë problematike, ku për shkak të respektimit të dëshirës së partnerit (një individ), mund të ndikohet autonomia e gruas në vendimarrje në raport me dëshirën, kohën, numrin dhe intervalin e lindjeve.

Është e nevojshme që ky parashikim të plotësohet dhe saktësohet, duke theksuar prioritizimin e gjendjes shëndetësore dhe vendimarrjes së gruas, psh. (Të drejtën të vendosin lirisht, por duke respektuar dëshirën e secilit partner-prioritizuar dëshirën dhe gjendjen shëndetësore të gruas që

mbart fëmijën, për kohën, numrin dhe intervalin e lindjeve) ose të renditet sërish nën seksionin e garancive për çdo grua.

3.Projektligji përdor parashikime gjeneralizuese mbi metodat e riprodhimit mjekësor të asistuar (RMA), duke eliminuar parashikimet e specifikuara në lidhje me Inseminimin Artificial dhe Fekondimin In Vitro

Koment:

Kjo mungesë specifikimi në parashikime dhe referimi i rregullimeve specifike në akte të tjera nënligjore është një praktikë problematike e cila rrezikon të lërë të parregulluara këto situata për një periudhë të pacaktuar, duke shkaktuar konfuzion në praktikën e mjekëve dhe në nivelin e garantimit të të drejtave për t'ju nënshtruar këtyre metodave për çdo individ.

4.Projektligji është diskriminues në raport me të drejtën e çdo individi për të pasur fëmijë, duke përfutur nga metodat RMA, duke mos ju përshtatur me efektivitet nevojave të realitetit shoqëror

Ligji aktual “Për Shëndetin riprodhues”, në nenet 10 dhe 30 të tij parashikon se “të gjithë individët dhe çiftet kanë të drejtë të përfitojnë nga: përdorimi i metodave të sigurta, të përballueshme dhe të pranueshme të planifikimit familjar, sipas zgjedhjes së tyre; ndaj metodave të tjera të zgjedhura për rregullimin e fertilitetit; nga progresi shkencor dhe teknologjitë e reja lidhur me riprodhimin e seksualitetin, kur ato janë të sigurta dhe të pranueshme”.

Projektligji i propozuar në nenet 15 dhe 19 të tij përcakton se “përdorues të këtyre teknikave do të jenë çiftet heteroseksuale dhe femra pa partner”.

Koment:

Ky ndryshim në parashikime është diskriminues ndaj së drejtës së çdo individi dhe çifti për të pasur fëmijë mes metodave RMA, duke përjashtuar nga garancitë çiftet e personave të së njëjtës gjini.

Në kushtet ku Shqipëria do të duhet të përshtasë legjislacionin aktual dhe sidomos atë të ri me realitetin shoqëror, standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut⁵⁵, në raport me njohjen ligjore të çifteve të së njëjtës gjini dhe të drejtës së tyre për të pasur fëmijë dhe familje, ky parashikim prezanton një barrierë diskriminuese për shkak të orientimit seksual, duke e rezervuar të drejtën për të përfutur nga RMA vetëm ndaj çifteve heteroseksuale

5.Projektligji nuk adreson efektivisht bazat potenciale për abuzim në mungesë të rregullimit të detajuar të konceptit të surrogacisë

Koment:

⁵⁵ ECRI- <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/albania>; CEDAW- <https://www.ohchr.org/en/documents/concluding-observations/cedawcalbco5-concluding-observations-fifth-periodic-report>

Parashikimet në lidhje me surrogacinë janë tejet të gjeneralizuara. Ato nuk përcaktojnë në mënyrë të detajuar elementet e marrëveshjes së surrogacisë, mënyrën e vendosjes së kundërshpërblimit, adresimin e situatave të shfrytëzimit, abuzimit dhe krijimit të bazave për trafikim të qenieve njerëzore. Do të duhej që ky parashikim të ishte pjesë e një seksioni të detajuar apo ligji të veçantë dhe të mos referonte në mënyrë të vazhduar në akte nënligjore, duke krijuar premisën e lënies së një situate të parregulluar, që krijon kushte të favorshme për situata abuzive.

Duke analizuar me kujdes standardet më të mira të praktikave surrogative, shteti shqiptar do të duhet të vendosi fillimisht nëse do të drejtohet ndaj surrogacisë me kundërshpërblim apo asaj mbi baza vullnetare dhe afektive⁵⁶. Po kështu do të duhet të analizohen me kujdes të veçantë shkaqet për të cilat lejohet surrogacia, përtej shkaqeve shëndetësore të infertilitetit, duke e drejtuar edhe drejt pamundësisë biologjike për të mbartur fëmijë (çështje të prindërimit për burrat në marrëdhënie të së njëjtës gjini; baballarë të vetëm etj.), në përputhje me përshtatjen e legjislacionit shqiptar me standardet e njohjes ligjore të bashkimeve të së njëjtës gjini dhe çështjeve të prindërimit, pa dallim dhe pa kurfarë diskriminimi për çdo individ.

6. Projektligji nuk referon në mënyrë efektive standardin e pëlqimit të informuar në lidhje me çdo vendimarrje dhe fazë procesi që përfshin aspekte të shëndetit seksual dhe riprodhues.

Koment:

Në çdo rast koncepti i pëlqimit të thjeshtë në projektligj do të duhet të zëvendësohet me konceptin e pëlqimit të informuar, ku stafi mjekësor (sipas rastit në bashkëpunim edhe me profesionistë të tjerë) informon në detaje dhe sigurohet që individ i ndikuar drejtpërdrejt nga vendimarrja kupton efektivisht pasojat dhe efektet e kësaj vendimarrjeje.”

Pra, Komisioneri vëren se, projekt ligji “Për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues”, ka qenë i publikuar, i hapur për vërejtje dhe komente, si dhe sugjerime nga grupet e interesuara dhe publiku.

Në këtë kontekst, znj. D. M, si aktiviste e njohur e shoqërisë civile, si dhe nënkryetare e Partisë Konservatore (sipas deklarimeve të saj), ka qenë e lirë që të gjitha vërejtjet, opinionet, sugjerimet për projekt ligjin e mësipërm, t’i depozitonte në formë shkresore pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi në thelb, kauzat, idetë apo programet e grupimeve të caktuara konkretizohen dhe bëhen të detyrueshme për t’u respektuar nga e gjithë shoqëria, kur, përmes procesit legjislativ hartohet, ndryshohet, shfuqizohet, miratohet një ligj, apo, refuzohet një projekt ligj- kjo, sipas kendvështrimit të grupeve të caktuara të interesit.

Komisioneri vlerëson të bazuara pretendimet e palës ankuese, se:

Mes deklaratave publike, shtetasja D. M insinuan pa asnjë bazë faktike se aktivistët dhe lëvizja LGBTI+ në vend ka një axhendë të mirëmenduar që ndjek një projekt pilot nga Kanadaja për të

⁵⁶ <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3531011/>

shkatërruar familjen tradicionale, duke krijuar në shoqëri ndjenja frike, paragjykimi, si dhe duke nxitur urrejtje ndaj komuniteteve LGBTI+ dhe kësaj kauze.

Këto deklarata kanë krijuar në publik perceptimin se komunitetit LGBTI+ dhe aktivistët po trokasnin në shkolla për të dhënë leksione “xhenderizimi dhe gjellëku”, duke referuar fakte të pavërteta se edhe në botën perëndimore kanë ndodhur këto “vizita” në shkolla, axhendë që po ndiqet edhe në Shqipëri, ku persona trans dhe drag queens shkojnë të veshur si djaj te fëmijët.

Po kështu, D. M ka referuar fakte, të cilat janë komplet të pabazuara, se në botën perëndimore aktivistët LGBTI+ marrin fëmijët në shkolla, u injektojnë hormone dhe i kthejnë në transgjinorë. Mes referimit dhe hamendësimit që ajo bën se lëvizja shqiptare LGBTI+ ndjek këtë frymë, ngre alarmin në shoqëri se këto ngjarje, plotësisht të pavërteta, do të ndodhin apo mund të ndodhin edhe në vendin tonë.

Komisioneri konstaton se, këto deklarata në përmbajtjen e tyre krijojnë një perceptim kërcënues dhe negativ ndaj grupit të personave LGBTI+, duke pretenduar dhe bërë thirrje publike për mbrojtje të familjes shqiptare nga kjo lëvizje dhe nga individët LGBTI+.

Këto deklarata arrijnë nivelin dhe mbartin përveç gjuhës diskriminuese, edhe keqinformim të publikut, duke pohuar se Aleanca LGBTI ka bërë një kërkesë për rregullimin seksual dhe të shëndetit seksual të fëmijëve, të rinjve, moshës së re në Shqipëri duke prekur rëndë familjet e reja shqiptare.

Komisioneri konstaton e vlerëson se: temat e abortit, lejimit të martesave brenda të njëjtit seks, surrogacisë, identitetit gjinor, zgjidhja e problematikave të personave LGBT, në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave, parimet që duhen zbatuar në shëndetin seksual dhe atë riprodhues, e që kanë lidhje me kushtet e kriteret për ndërprerjen e shtatzënisë, riprodhimit mjekësor të asistuar (RMA⁵⁷), dhe a duhet të përfitojnë nga kjo e drejtë çiftet e personave të të njëjtit seks dhe femrat pa partner, mundësisë për të pasur fëmijë apo birësim, etj - janë tema shumë të debatuar në botën perëndimore dhe tani së fundmi edhe në Shqipëri.

Me të drejtë, këto tema kardinale e të rëndësishme që ndërthurin shumë problematika e ekuilibra si: tradita, zakoni, familja, martesa, të drejtat e njeriut, barazia para ligjit, liria, besimi, religjioni, etj, kanë krijuar debate ku janë të përfshirë akademikë, studiues, sociologë, gazetarë, Papati, përfaqësues të të gjitha feve e besimeve, bota universitare, shoqata, parti politike, përfaqësues e titullarë të institucioneve shtetërore e qeveritare.

Rëndësia e debatit qëndron jo vetëm për palët e përfshira, por, edhe për shoqërinë në tërësi, pasi ruan dhe zhvillon vlerat njerëzore, përmes evoluimit të mendimit e ideve, duke arritur në kompromise të pranueshme nga shoqëria, e cila për rrjedhojë pasqyrohet në ligje dhe akte normative, që rregullojnë fushat përkatëse, për të cilat është zhvilluar debati.

⁵⁷ Inseminimin artificial dhe fekondimin invitro.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Historia njerëzore qoftë edhe ajo jo shumë e largët, ka treguar se mbrojtja e çdo lloj kauze e ideje, por që shoqërohet me gjuhë urrejtjeje, nënçmuese, denigrese, duke targetuar apo nënkuptuar një shtresë, grup, popullatë, etnitet të caktuar, për të cilët krijohet edhe një stereotip negativ, pra, që ky perceptim nxit një valë indinjate, përçmimi, ka çuar shoqëri të tëra në tronditje e plagë të thella, e jo në pak raste, kanë formësuar e ngjizur ideologji e doktrina, që kanë shkaktuar drama, tragjedi e krime.

Debatet mediatike dhe jo vetëm, duhet t'i vlejné maturimit të ideve, kompromisit shoqëror dhe përparimit e civilizimit të mëtejshëm të shoqërisë si një e tërë .

Komisioneri vëren se, askush nuk duhet të pengohet për të shprehur lirshëm mendimet e idetë e tij, si vlera të njeriut, të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa e të Drejtave të Njeriut.

Znj. M i ka shprehur dhe duhet t'i shprehë e mbrojtë idetë dhe pozicionin që përfaqëson, dhe kjo është një vlerë qytetëruese që jo vetëm duhet dëgjuar me vëmendje, por edhe duhet respektuar.

Por, mbrojtja e ideve duhet bërë me argumenta, dhe vetëm brenda argumentit, me gjuhë e shprehje etike, me të dhëna e prova të sakta, me referime konkrete e jo përgjithësime. Kur debati vishet me pohime, fakte të pavërteta apo gjysëm të vërteta, kur rasti përgjithësohet dhe i vishet apo targetohet, apo i nënkuptohet një grupi shoqëror (LGBT) si dhe duke i veshur përherë ngjyra negative, atëherë sigurisht që, këto deklarata krijojnë, nxisin, targetojnë në një pjesë të opinionit publik - si fajtorë, përgjegjës për “sulmin” ndaj familjes e fëmijëve - këtë grup shoqëror LGBT, interesat e të drejtat e të cilëve përfaqësohen e mbrohen edhe nga Qendra “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”.

Znj. D. M është një personazh e personalitet jo pak i njohur televiziv e mediatik, si dhe në rrjetet sociale, ndaj, deklaratimet e saj mbase jo drejtpërdrejtë drejtohen për “Aleancën kundër Diskriminimit LGBT”, por, nga një pjesë e publikut perceptohet dhe atashohet pikërisht tek grupimi që mbron “Aleanca”.

Komisioneri vlerëson faktin se, këto shprehje e deklarime bëhen nga një personazh i njohur publik në televizione e transmetime publike, me një audiencë të konsiderueshme apo në podcaste e rrjete sociale, lirisht e lehtësisht të aksesueshme, atëherë tek një pjesë e publikut, afektojnë panikun, frikën, ankthin për familjen, nga personat LGBT, duke nxitur rrjedhimisht përçmim e urrejtje ndaj këtij komuniteti.

Në këtë vendim janë evidentuar, numri i personave që kanë shikuar emisionet e mësipërme (deri në momentin e përpilimit të këtij vendimi) në You tube, pa përfshirë numrin e personave që e kanë shikuar drejtpërdrejtë në kanalet televizive apo në platformat e tjera sociale.

Sekuenca të deklaratimeve të znj. D. M janë hedhur edhe në platformën e Tik Tok (aktualisht e bllokuar me vendim të Këshillit të Ministrave, por de facto me instalimin e VPN, e aksesueshme), ku për shkak të teknologjisë dhe opsioneve, ka një përdorim tejet të lartë e me shumë impakt, sidomos tek të rinjtë.

Konkretisht, deklaratimet e znj. M, në emisionin “Shqipëria Live”, të datës 24.12.2024, në Top Channel, janë të hedhura në Tik Tok, e, referuar komenteve të publikut *(ku vetëm tek një faqe e një përdoruesi në Tik Tok⁵⁸, ka mbi 2000 (2 mijë) komente, pa llogaritur me qindra përdorues të tjerë të Tik Tok-ut, të cilët pasqyrojnë të njëjtin episod. Kjo sekuencë vetëm nga kjo faqe është shpërndarë edhe tek 3061 përdorues të tjerë të kësaj platforme)*, që janë në masë të konsiderueshme, konstatohet lehtësisht se deklaratimet e saj, kanë përçarur si efekt reagues nga publiku, një gjuhë përçarëse, fyese, sharëse, denigruese, agresive me intimidime e kërcënime për jetën *(vrasje me plumb, etj, etj.)*

Përveç të tjerave, Komisioneri vëren se, në deklaratimet publike e mediatike nga persona të njohur e publik, kur trajtohen tema të ndjeshme e delikate, duhet mbajtur parasysh: koha, vendi dhe niveli ekonomik, shoqëror, kulturor, arsimor i vendit, që, për rastin e vendit tonë, për shkaqe historike, por edhe të tranzicionit pas diktaturës 45-vjeçare, paraqitet me dallime e disnivele të ndryshme kulturore e arsimore.

Për rrjedhojë shprehjet negative kundrejt grupeve të ndryshme kanë impakt të ndryshëm, ku impakti më i rëndë evidentohet pikërisht mbi ato grupe që rezultojnë të paragjykuara, stereotipizuara, diskriminuara dhe negativisht të perceptuara nga shoqëria.

Sigurisht që tek shtresa apo personat jo të mirë arsimuar, deklarime të tilla merren jo vetëm të mirëqena, por mbjellin farën e reaksionit negativ ndaj personave LGBT, prezenca e të cilëve perceptohet si një rrezik imediat e asgjësues për familjen e shoqërinë në tërësi.

Formimi intelektual, gjuhësor, leksikor, si dhe përvoja jetësore e znj. D. M, janë të atij shkalle e niveli, që mund të shprehë kuptueshëm, pa pengesa e në mënyrë shteruese pikëpamjet, idetë që përfaqëson e mbron, pa krijuar aludime për teori konspirative, të komplotit, agjendës perëndimore, e që e ka pushtuar këtë të fundit, e cila po vjen të implementohet në Shqipëri, me synim shpërbërjen e familjes dhe vlerave njerëzore.

Deklarime e pohime të tilla, të cilat targetojnë apo nënkuptojnë si personat e komunitetit LGBT, apo dhe vetë “Aleancën LGBT”, i ekspozojnë këta të fundit përballë një ankthi, paniku, shqetësimi dhe urrejtjeje që krijohet tek një pjesë e publikut, ndaj “Agjendës liberale”, që po imponohet e implementohet në Shqipëri në “favor” të personave të komunitetit LGBT, e në dëm të pjesës tjetër të publikut.

Në analizë të rrethanave e fakteve të trajtuara sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, deklaratimet e znj. D. M në emisionet e analizuara, marrë në veçanti, por edhe në tërësi, në koherencë me njëri-tjetrin, kanë përçarur gjuhë urrejtjeje duke pasur parasysh: kontekstin në të cilën është përdorur kjo gjuhë, aftësinë e saj për të ushtruar ndikim mbi të tjerët- duke qenë një personazh i njohur mediatik dhe aktiviste shoqërore si dhe nënkryetare e Partisë Konservatore, natyrën dhe forcën e gjuhës së përdorur, e drejtpërdrejtë, duke përfshirë stereotipizimin negativ, e aftë të nxisë frikësim, armiqësi e diskriminim, mediumin dhe formatin e përdorur- në televizione dhe podcaste, me audiencë të

⁵⁸Faqja - TE NDRYSHME #1? -

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

madhe, natyrën e publikut, i cili paraqitet i ndjeshëm për t'u përfshirë në reagime me sharje, fyerje, agresivitet e sjellje diskriminuese.

Mbrojtja e një kauze, ideje, ideologjie të caktuara, përtej forcës së argumentit, por me terma e shprehje që targetojnë persona, grupe të caktuara apo të presupozuara si “agjendë” që ndjek politikën e “gejizimit” të shoqërisë, dëmtimit të familjes e fëmijëve, përveçse shkakton e përçon një ankth, panik e alarm shoqëror, në vetvete mjetet e zgjedhura e të përdorura për mbrojtjen e kauzës, mbeten thjesht populiste.

Nga ana tjetër, edhe mbrojtja, promovimi i të drejtave e garancive ligjore të komunitetit LGBT, rritja e vëllimit të të drejtave, duhen kërkuar, argumentuar si në prezantime publike, mediatike, televizive, media të ndryshme etj, ashtu dhe në instancat përkatëse shtetërore.

Opinionimi publik duhet ndërgjegjësuar për rëndësinë e të drejtave të personave/komunitetit LGBT, me argumenta përkatëse e transparencë, duke respektuar legjislacionin në fuqi. Imponimet mes palëve në dialog, me gjuhë të papërshtatshme e për më tepër urrejtjeje, janë të papranueshme, dhe përbëjnë terren pjellor për nxitjen e ekstremizmit e dhunës verbale.

Në shqyrtimin të prapësimeve e pretendimeve të znj. D. M, Komisioneri vlerëson se:

Edhe pa iu drejtuar e pa përmendur fare Qendrën “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”, por thjesht duke trajtuar me agresivitet, gjuhë të papërshtatshme, fyese - tematika e problematika që shtrihen në fushën e veprimit të kësaj organizate/Qendre, (sipas statutit dhe akt themelimit të saj, të miratuara si në përputhje me ligjin, nga Gjykata, në momentin e regjistrimit) dhe të veprimtarisë së zhvilluar prej saj, (Aleancës kundër Diskriminimit LGBT), përbën diskriminim, si ndaj personave/komunitetit LGBT në përgjithësi, ashtu dhe ndaj “Aleancës kundër Diskriminimit LGBT” (Qendrës) në veçanti.

Gjithashtu, deklaratimet se persona të identifikuar ose jo, kanë shkuar në një shkollë të caktuar, duke propaganduar tek nxënësit, fëmijët “gejizimin” dhe “Agjendën LGBT”, mbeten në kuadrin e aludimeve dhe si të tilla janë të pa provuara, e për rrjedhojë dizinformojnë dhe nxisin negativitet të shoqërisë kundrejt këtyre grupeve.

Si çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, znj. D. M ka të drejtën dhe detyrimin ligjor që, për çdo rast që konstaton veprime të kundraligjshme ndaj fëmijëve në shkolla apo kudo tjetër, t'i drejtohet me ankesë, kallëzim, organeve shtetërore, përfshirë policinë, prokurorinë, ndaj personit, personave apo grupeve të caktuara, që kryejnë veprime të dënueshme ndaj shëndetit e mirëqenies së fëmijëve, dhe të presë rezultatet e hetimeve administrative apo gjyqësore e vendimet përkatëse të tyre.

Komisioneri vëren se, gjuha e urrejtjes është një fenomen social dhe juridik që ka tërhequr vëmendje të madhe në dekadat e fundit, sidomos për shkak të ndikimeve të saj në shoqëri dhe individë. Ky fenomen përfshin veprime dhe sjellje që promovojnë urrejtje dhe diskriminim ndaj një grupi ose individi për shkak të racës, religjionit, etnisë, orientimit seksual apo karakteristikave të tjera, përbën një sfidë për shumë vende, përfshirë Shqipërinë.

Gjuha e urrejtjes përkufizohet ligjërisht si deklarata ose veprime që nxisin dhunë, urrejtje ose diskriminim ndaj një grupi të caktuar të njerëzish për shkak të karakteristikave të mbrojtura të tyre.

Këto karakteristika mund të përfshijnë racën, etninë, religjionin, gjininë, orientimin seksual, dhe të tjera. Përkufizimet ligjore zakonisht synojnë të krijojnë një bazë për ndjekje penale dhe për ndëshkimin e individëve ose organizatave që përhapin gjuhë urrejtjeje.

Në nivel ndërkombëtar, përkufizimi ligjor i gjuhës së urrejtjes është i përfshirë në disa traktate dhe konventa të cilat Shqipëria i ka ratifikuar. Neni 4 i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD) nënvizon ndalimin dhe dënimin e përhapjeve të ideve të bazuara në epërsi racore ose urrejtje racore, apo nxitjen e dhunës kundër çdo race ose grupi tjetër (ICERD, 1966, Neni 4).

Gjithashtu, neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) parashikon që liria e shprehjes mund të kufizohet kur është e nevojshme për mbrojtjen e rendit publik, sigurisë kombëtare dhe parandalimin e krimit, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes.

Në literaturën akademike, gjuha e urrejtjes trajtohet si një formë e ekstremizmit verbal që ka për qëllim dehumanizimin dhe stigmatizimin e individëve ose grupeve (Sponholz, 2023). Studiuesit e shohin gjuhën e urrejtjes si një mënyrë për të legjitimuar diskriminimin dhe dhunën kundër grupeve të caktuara, duke përdorur retorikë që i shndërron këta individë në "të tjerë" të cilët janë të denjë për përbuzje ose trajtim të pabarabartë (Abramovic, 2022). Gjuha e urrejtjes jo vetëm që ndikon viktimat në mënyrë të drejtpërdrejtë, por gjithashtu dëmton kohezionin social dhe rrit tensionet ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri.

Fjalimi që nxit urrejtje dhe diskriminim ndaj personave ose grupeve të caktuara bazuar në orientimin e tyre seksual njihet si fjalim homofobik dhe mund të marrë disa forma, të tilla si përkufizime përçmuese apo stereotipe të ndryshme.

Nëpërmjet retorikës homofobike, shëndeti emocional dhe psikologjik i familjeve LGBTQ+ dëmtohet dhe e cila gjithashtu ndihmon në stigmatizimin dhe marginalizimin e tyre në shoqëri (Herek, 2009).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ), në çështjen Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë (2012), ka trajtuar lirinë e shprehjes dhe fjalimin homofobik. Në këtë çështje, një grup individësh u ndoqën penalisht për shpërndarjen e materialeve homofobike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konkludoi se liria e shprehjes nuk garanton nxitjen e urrejtjes dhe se shteti kishte të drejtë të ndalonte fjalimin homofobik (Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë, 2012).

Në një rast tjetër, M. kundër Gjermanisë (2015), M u përball me dhunë dhe diskriminim për orientimin e tij seksual. Në vendimin e saj, GjEDNJ konfirmoi se shteti kishte detyrimin të ndërmerre veprime për të mbrojtur individët nga fjalimi homofobik dhe dhuna që rrjedh prej këtij fjalimi (M. kundër Gjermanisë, 2015).

Siç shihet nga këto raste, Gjykata Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka luajtur një rol të rëndësishëm në lirinë e shprehjes dhe kufizimin e saj lidhur me retorikën homofobike. Në përputhje me keto detyrime, legjislacionet kombëtare të shteteve anëtare dënojnë fjalimet që nxisin dhunë, urrejtje ose diskriminim ndaj grupeve të veçanta, duke përfshirë njerëzit që kanë një orientim të ndryshëm seksual

Terminologjia e përdorur në mënyrën jo të duhur në faqet e internetit apo mediat sociale, është një tipar tjetër që nxit urrejtjen, paragjykimin ose ndarjen e mendimeve të një personi me të tjerët. Interneti është një mjedis ku gjuha e urrejtjes mund të përhapet me shpejtësi dhe gjerësisht.

Grupe të caktuara stigmatizohen dhe marginalizohen si rezultat i kësaj përhapjeje, e cila ka një ndikim të rëndësishëm në jetë dhe shoqëri. Shumë vende kanë miratuar legjislacion kundër gjuhës së urrejtjes, por është ende e vështirë të zbatohen në botën virtuale. Në çështjen Delfi AS kundër Estonisë (2015) Gjykata Evropiane të të Drejtave të Njeriut vendosi që gjuha e urrejtjes e përhapur përmes mediave sociale dhe internetit nuk mbrohet nga e drejta e fjalës së lirë. Në këtë rast, një organizatë estoneze e lajmeve u akuzua se nuk mori masat e nevojshme dhe të duhura për të ndaluar përdoruesit e saj të postonin komente provokuese dhe abuzive që nxisnin gjuhën e urrejtjes në faqen e saj të internetit.

Gjykata Evropiane vendosi që megjithëse interneti është një mjet i vlefshëm për informacion dhe opinione, interneti nuk duhet të përdoret për të promovuar gjuhën e urrejtjes dhe për të nxitur dhunën.

Ky vendim e bëri të qartë se autoritetet dhe platformat online duhet të ndërmarrin veprime kundër përhapjes së gjuhës së urrejtjes për të mbrojtur sigurinë e shoqërisë. Gjithashtu është shumë e rëndësishme përmbajtja e kësaj platforme për të mos rrezikuar individët dhe shoqërinë nga ofendimet apo nxitjet e dhunës, por t'u krijohej një mbrojtje sociale.

Duket qartazi që dhe në mjedisin virtual liria e shprehjes kur individë të ndryshëm të shoqërisë rrezikohen, apo diskriminohen grupe të caktuara ajo mund të kufizohet (Delfi AS v. Estonia, 2015).

Rasti Mouvement Rawlien Suisse kundër Zvicrës (2012) është një çështje e rëndësishme e trajtuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) që lidhet me përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe rolin e autoriteteve shtetërore në ndalimin e saj, veçanërisht në mjedisin e internetit dhe mediave sociale. Në këtë rast, Mouvement Raëlien Suisse një grup i lëvizjes Raelian u akuzua për shpërndarjen e mesazheve dhe informacioneve me përmbajtje raciste dhe diskriminuese ndaj hebrenjve në internet si dhe platforma të tjera mediatike. Meqenëse këto komunikime u konsideruan të dëmshme dhe në kundërshtim me rregullat që ndalojnë promovimin e gjuhës së urrejtjes, grupi u ndoq ligjërisht nga autoritetet zvicerane.

Gjykata analizon në vendimin e saj se autoritetet zvicerane vepruan në përputhje me ligjin për të mbrojtur të drejtat e individëve dhe grupeve që janë shpesh objektiva nga krimet e përhapjes së urrejtje dhe diskriminimit sidomos duke pasur parasysh se sa lehtë dhe shpejt mund të shpërndahen këto materiale në internet.

Duke qenë se kërkohej të mbrohej rendi publik dhe të drejtat e tjera të individëve që prekeshin nga këto mesazhe, gjykata pohoi se ndërhyrja e autoriteteve për të ndaluar përhapjen e materialeve që nxisinin gjuhë urrejtje dhe diskriminim ishte e justifikuar. Aspekti kryesor i këtij vendimi është që shtetet duhet të kontrollojnë përmbajtjen e platformave online, dhe të internetit për të shmangur apo reduktuar përhapjen dhe nxitjen e gjuhës së urrejtjes të cilat janë të dëmshme për një shoqëri.

Gjykata nënvizoi në vendim se duhet gjetur një ekuilibër i kujdesshëm midis nevojës për të mbrojtur lirinë dhe domosdoshmërisë për të mbrojtur shprehjen e shoqërisë nga deklaratat që nxisin urrejtje ose dhunë. Pavarësisht se është një e drejtë themelore, liria e shprehjes mund të kufizohet kur ajo përbën një kërcënim për të drejtat e tjera shoqërore.

Ky vendim shërben si një shembull i qartë se si shtetet duhet të kontrollojnë internetin dhe platformën e mediave sociale për të parandaluar përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe intolerancës duke siguruar që e drejta për fjalën e lirë të mos të rrezikojë sigurinë dhe harmoninë shoqërore (Mouvement Raëlien Suisse kundër Zvicrës, 2012).

Në një sërë vendimarrjesh të tjera, duke përfshirë Perinçek; Le Pen v. France; Kasymakhunov dhe Saybatalov v. Russia; Vejdeland dhe të tjerë v. Sweden; Beizaras dhe Levickas v. Lithuania dhe Féret v. Belgium, GJEDNJ ka zgjeruar konceptin e gjuhës së urrejtjes duke përfshirë në të nxitjen e diskriminimit, të cilën e konsideron një "formë të nxitjes së intolerancës në shoqëri, e cila, së bashku me nxitjen e urrejtjes ndaj një apo disa individëve, përbën një nga kufijtë që nuk duhet të kapërcehen kurrë në ushtrimin e lirisë së shprehjes nga asnjë individ apo subjekt". Me referencë në vendimarrjet e këtyre çështjeve, GJEDNJ shprehet se kufizimi i nevojshëm i lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike shtrihet edhe mbi deklaratat negative të bëra publikisht ndaj një grupimi (etnik, fetar ose tjetër) që mbartin konotacion fyes, tallës, shpifës dhe portretizojnë në një mënyrë negative të gjithë këtë grupim popullsie⁵⁹.

Po kështu, në vendimarrjen Beizaras dhe Levickas v. Lithuania⁶⁰, GJEDNJ u shpreh se hezitimi i autoriteteve lituaneze për të trajtuar me seriozitet përmbajtjet diskriminuese online që përmbanin elemente të gjuhës diskriminuese dhe të urrejtjes mbi bazat e orientimit seksual përbënte shkelje të së drejtës së individëve me orientim të ndryshëm seksual për jetë private pa kurfarrë diskriminimi (shkelje e nenit 8 në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së).

Në Lilliendahl v. Iceland⁶¹, aplikanti pretendoi shkelje të lirisë së tij të shprehjes, pasi autoritetet islandeze e kishin dënuar për gjuhë urrejtjeje për shkak të postimeve dhe publikimeve të tij online që përfshinin deklarata se homoseksualët janë "devijantë seksualë" dhe duhet "të sabotohen nga

⁵⁹ Perinçek, op. cit., para 206; Le Pen v. France, dec. of 10 May 2010, appl. no. 55173/00; Kasymakhunov and Saybatalov v. Russia, judgment of 14 March 2013, appl. no. 26261/05 et al; Vejdeland and Others v. Sëeden, judgment of 9 February 2012, appl. no. 1813/07, para 55; Beizaras and Levickas v. Lithuania, judgment of 14 January 2020, appl. no. 41288/15, para 125; Féret v. Belgium, judgment of 16 July 2009, appl. no. 15615/07, para 73.

⁶⁰ Beizaras and Levickas v. Lithuania (2020), Case No.: 41288/15.

⁶¹ Lilliendahl v. Iceland (2021), Case No.:29297/18.

shoqëria". GJEDNJ u shpreh se në këtë rast kufizimi i lirisë së shprehjes së aplikantit kishte qenë i nevojshëm, i ligjshëm dhe proporcional në një shoqëri demokratike, duke vënë në dukje se komentet përbënin gjuhë urrejtjeje dhe kishin për qëllim portretizimin negativ dhe nxitjen për diskriminim ndaj individëve LGBTI+. Ky rast përforcoi parimin se gjuha e urrejtjes në mediat sociale duhet të merret seriozisht nga autoritetet shtetërore dhe të kufizohet për të mbrojtur dinjitetin dhe sigurinë e individëve LGBTI+ në sytë e shoqërisë.

Për këtë arsye, zbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së është i domosdoshëm për të adresuar këtë problem. Kjo përfshin jo vetëm ndalimin e gjuhës së urrejtjes, por gjithashtu mbrojtjen e individëve nga diskriminimi dhe sulmet verbale që kanë për qëllim të dëmtojnë dinjitetin dhe lirinë e shprehjes.

Komisioneri konstaton se, një nga çështjet më të rëndësishme është lufta kundër gjuhës së urrejtjes, e cila vazhdon të mbetet një problem i rëndësishëm në Shqipëri. Gjuha e urrejtjes, që shpesh përdoret në komunikimin publik dhe online, është një shkelje e drejtpërdrejtë e dinjitetit njerëzor dhe një rrezik për rendin shoqëror dhe kohezionin e shoqërisë.

Personat e komunitetit LGBTI kanë qenë dhe vazhdojnë ende të jenë subjekte të homofobisë, transfobisë dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se për shkak të vulnerabilitetit të këtij grupimi është e nevojshme që të ndërmerren masa të menjëhershme për të ndaluar çdo përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave.

Komisioneri, vlerëson të theksojë se, jo mbi të gjitha grupet shoqërore shprehje të tilla rëndojnë njëllë. Është në vëmendje të KMD-së, që vetë shteti Shqiptar, ka njohur si strukturalisht dhe sistematikisht të diskriminuara disa grupe shoqërore nga organet publike dhe vetë shoqëria. Kjo provohet edhe nga strategjitë e veçanta që Qeveria ka përpiluar, si p.sh: Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Plan i Kombëtar për Persoant me Aftësi të Kufizuar (PAK) 2021-2025, Plan i Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 (këtu e në vijim “PKVBPPRE 2021-2025”), Plan i Kombëtar të Veprimit (PKV) për komunitetin LGBTI (2021-2027), etj. Për këtë arsye shprehjet e përdorura në tejkallim të lirisë së shprehjes duke portretizuar negativisht këto grupe shoqërore, nëpërmjet denigrimit, dezinformimit si dhe amplifikimit të paragjyqimeve dhe stereotipeve negative, rëndojnë disproporcionalisht dhe krijojnë sjellje diskriminuese në formën e gjuhës së urrejtjes.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e Firmës Feryn (*Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër Firmës Feryn NV*, C-54/07, 10 korrik 2008), ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet një viktimë. Komisioneri vlerëson se në çështjen në fjalë, gjuha e përdorur përcjell një gjuhë urrejtjeje të pajustificuar, saqë edhe në mungesë të identifikimit të një individi konkret si viktimë diskriminimi, mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese, do të cënonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 8 parashikon se: “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.”.

Siç vërehet, në nenin e sipërcituar referohet “...çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet...”, çka do të thotë që në kuptim të ligjit çdo mënyrë publike e të shprehurit që krijojnë premisën e parashikuar në këtë formë diskriminimi është dhe duhet hetuar. Aq e vërtetë është kjo sa është praktikë e gjerë e GJEDNJ që të hetojë dhe të shprehet edhe në rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes me mjete tjera jo tradicionale si rrjete sociale, portale on line apo edhe komente nga përdoruesit.

Për këtë qëllim sjellim në vëmendje standardet e Këshillit të Evropës në lidhje me gjuhën e urrejtjes, nëpërmjet Rekomandimit nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për luftimin e gjuhës së urrejtjes”⁶² (materiali në link), në bazë të cilit është mbështetur edhe legjislatori shqiptar në përkufizimin e kësaj forme diskriminimi në Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Po ashtu, edhe jurisprudencën dhe vendime konkrete të GJEDNJ-së në lidhje me format dhe mjetet e shprehura të gjuhës së urrejtjes dhe kuptimit të saj nga kjo gjykatë.⁶³

Në frymë të këtij rekomandimi dhe jurisprudencës së sipërcituar, shqetësimi lidhet me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, pavarësisht nga mjeti i përdorur. Sidomos në rastet kur personi i prezumuar që ka përdorur gjuhë urrejtje e ka bërë këtë me zë dhe me figurë, i identifikuar me emër dhe mbiemër, në një rrjetet sociale e mediatike, ku është aksesuar nga çdo njeri dhe shpërndarë nga një numër i konsiderueshëm personash.

Në përfundim, në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, rëndësi ka që përdorimi dhe emetimi i saj, pavarësisht mjetit të përdorur, ka ndodhur ose/dhe vazhdon të ndodhë dhe krijon shqetësim në shoqëri e akoma më tepër në grupe shoqërore të konsideruara pakica dhe të njohura si sistematikisht të diskriminuara.

⁶² <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech-alba/16809eb58e>

⁶³ Çështja Jersild kundër Denimarkës 23 Shtator 1994 – Fragmente nga dokumentar;

Çështja Gündüz kundër Turqisë 4 Dhjetor 2003 – Debat televiziv;

Çështja Erbakan kundër Turqisë 6 Korrik 2006 – Fjalim publik;

Çështja Pavel Ivanov kundër Rusisë 20 Shkurt 2007 – Artikull i shkruar;

Çështja Féret kundër Belgjikës 16 July 2009 – Fletëpalosje;

Çështja Delfi AS kundër Estonisë 16 Qershor 2015 – Koment në një portal në internet;

Çështja Belkacem kundër Belgjikës 27 June 2017 – Komente në Youtube;

Çështja Šimunić kundër Kroacisë 22 Janar 2019 – mesazhe në një ndeshje futbolli;

Çështja Beizaras dhe Levickas kundër Lithanisë 14 January 2020 – Komente në Facebook;

Çështja Lilliendahl kundër Islandës 12 Maj 2020 – Komente në një artikull on line;

Çështja Zemmour v. France 20 dhjetor 2022 – Deklaratë në emision televiziv;

Çështja Valaitis kundër Lithuanisë 17 January 2023 – Komente në internet

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuara më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, gjuha e përdorur nga z. Znj. D. M, përbën gjuhë urrejtje kundër personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, po ashtu edhe ndaj qendrës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura prej saj, janë në tejkalim të lirisë së shprehjes dhe si të tilla ato nuk mund të gëzojnë mbrojtje nga nenet 22 dhe 24 të Kushtetutës, nenet 9 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neneve 18 dhe 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se kufizimi i gjuhës së urrejtjes është i domosdoshëm dhe proporcional⁶⁴.

Komisioneri thekson se, forca dhe demokratizimi i një shoqërie pasqyrohet tek niveli i të drejtave të pakicave apo grupeve vulnerabël dhe garantimi e respektimi i tyre.

Në nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa mbështetur në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji nuk ka përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës diskriminuese, atribut ky që është lënë në diskrecionin e Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri vendos rast pas rasti, se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të individëve që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë detyrimi i znj. D. M, që të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe “Aleancës kundër Diskriminimit LGBT”. dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.

➤ **Në lidhje me deklaratimet e znj. M në emisionet: “Shije shtëpie”, “Alarm” dhe “Kosova Today”, rezultojnë se:**

Në shoqëritë multikulturore, të cilat karakterizohen nga shumëllojshmëri traditash dhe mënyrash jetese, ndonjëherë është e nevojshme që e drejta për lirinë e shprehjes të ekuilibrohet me të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, ose të drejtën për të qenë i mbrojtur nga diskriminimi. Arritja e kësaj mbrojtjeje, bëhet përmes balancës mes tyre, pasi këto të drejta përbëjnë shtyllat themelore të një “shoqërie demokratike”.

Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor të përshtatshëm për të trajtuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe për ndalimin e diskriminimit. Si anëtare e Këshillit të Evropës dhe shtet kandidat në Bashkimin Evropian, Shqipëria është pjesë e akteve ndërkombëtare përkatëse. Shqipëria ka përmirësuar shpesh legjislacionin me synim harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe të

⁶⁴ Për analogji citojmë disa nga vendimet e KMD-së, në të cilat është konstatuar përdorim i gjuhës së urrejtjes, vendimet me: Nr. 172, datë 28.08.2023, Nr. 199, datë 11.10.2023, Nr. 23, datë 19.01.2024, etj.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Bashkimit Evropian. Legjislacioni aktual vlerësohet se është në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi gjuhën e urrejtjes, elaboruar hollësisht më lart në vendim.

LMD, në nenin 3, pika 8 e tij, ka përcaktuar se, “*Gjuha e urrejtjes*” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Komisioneri thekson se, *gjuha e urrejtjes*”, konsiderohet e tillë, kur ajo përdoret që të nxisë apo krijon pritshmërinë që të ketë efektin e nxitjes, drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personit/personave të shenjëstruar, që në rastin konkret pretendohet nga pala ankuese, kundrejt personave LGBT apo Aleancës kundër Diskriminimit LGBT.

Nisur nga kohëzgjatja në sekonda e materialit të emisioneve të mësipërme, të vëna në dispozicion nga pala ankuese (respektivisht 56, 12 dhe 51 sekonda), rezulton se: konteksti tërësor i pohimeve e deklarimeve të znj. M, nuk mund të të çojë në një konkluzion kategorik për sa pretendohet, por, me aq sa dëgjohet në ato sekonda, rezulton se, janë mendime të shprehura brenda një debati, por që nuk shprehin as gjuhë urrejtjeje, as gjuhë përçmuese, denigruese e stigmatizuese ndaj një komuniteti të caktuar LGBT, apo Qendrës “Aleanca”, në rastin konkret.

Znj. M ka idetë e saj për familjen, bashkëjetesën mes LGBT, fëmijëve etj, të cilave u qëndron konsekuente, dhe, aktivizmi i saj shoqëror e mediatik në mbrojtje të këtyre ideve dhe vlerës së familjes, duhet përgëzuar, përderisa, etika, gjuha, shprehjet e saj nuk targetojnë grupet LGBT.

Për emisionin Kosova Today, Komisioneri, konstaton se, transkripti i sjellë nga pala ankuese është: “Komuniteti LGBT + dhe Agjendat liberale janë shumë të rrezikshme për qënien njerëzore dhe për njeriun e ri. Dhe te njeriu i ri do të sjelli edhe prekje në trup dhe në shëndet.”

Por, nga dëgjimi i audios Komisioneri konstaton se, lidhur me këtë pjesë të emisionit, në fjalinë e mësipërme, nuk thuhet komuniteti LGBTI+, por, transkripti i saktë është: *“Por, Agjendat liberale janë shumë të rrezikshme për qënien njerëzore dhe për njeriun e ri. Dhe te njeriu i ri do sjelli edhe prekje në trup dhe në shëndet.”*

Për tre emisionet e mësipërme, referuar transkriptit të tyre, nuk rezulton që deklaratimet e znj. D. M (pavarësisht dakordësisë apo jo me deklaratimet e saj) të përçojnë gjuhë urrejtjeje.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ngritur nga pala ankuese se, gjuha e përdorur dhe deklaratat e znj. M, në daljet mediatike (sipërcituar, emisionet: “*Shije shtëpie*”, “*Alarm*” dhe “*Kosova Today*”) nxitin urrejtjen apo përbëjnë gjuhë urrejtjeje kundrejt personave LGBT apo Qendrës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”, është i pabazuar, dhe se, nuk përbën “*gjuhë*

*urrejtje*⁶⁵” në kuptim të nenit 3, pika 8, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” kundrejt personave që i përkasin komunitetit LGBTI+, dhe Qendrës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si pasojë e gjuhës së përdorur nga znj. D. M, në deklaratat e saj në emisionet televizive e podcastet: “Bardh a Zi, datë 22 Maj 2024”, “Podcard – ShpresON, datë 16 Maj 2024”, “Podcard – ShpresON, datë 18 Maj 2024”, “Shqipëria Live, datë 24 Dhjetor 2024”, “E Diell, datë 12 Janar 2025” dhe “Tru Podcast nga Sh. G, datë 5 Janar 2025”.
2. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, znj. D. M, në cilësinë e personit që ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe qendrës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT” dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, znj. D. M, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁶⁵ Nga praktika e KMD-së për rastet e ngjashme, citojmë vendimet e Komisionerit, me: nr. 218/2021, nr. 233/2021, nr. 109/2022, nr. 250/2023.